



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:079482

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05493982

PKR.nr.198/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Rënda, në përbërje të trupit gjykues prej Kryetarit të Trupit Gjykues – Gjykatësit **Drilon Haraçia** dhe gjykatësve profesional **Sulltan Dobraj Rashkaj dhe Mizahir Shabani** - anëtar, me zyrtaren ligjore Arbënore Basha, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarit P.Gj., nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes nga neni 178 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP/I.nr.26/2019, të datës 29.11.2019, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor me datat 26.07.2023, 29.09.2023, 16.11.2023, 20.12.2023, 02.02.2024 dhe dt. 26.02.2024, në prezencën e Prokurores së Shtetit Ardita Beqiraj - Hyseni, të dëmtuarit V.B., dhe përfaqësuesit të palëve të dëmtuara av.Natall Bullakaj, të dëmtuarit A.N., dhe përfaqësuesit të dëmtuarit av.Prek Kola, sipas autorizimit, me datën **28.02.2024** mori dhe publikisht shpalli, ndërsa e përpiloi **me dt.22.03.2024**, këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

P.GJ., nga i ati ... e ëma ..., e gjinisë .. i lindur me datën .. në fshatin .I, Komuna e Gjakovës, ku edhe tani jeton, i martuar, baba i gashtë (6) fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, me profesion punëtor artizanal i veglave muzikore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: ..

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 12.03.2019, rreth orës 18:30, në fshatin ... Komuna e Gjakovës, pikërisht afër shtëpisë së A.N., me dashje e ndihmon këtu të akuzuarin A.Gj., duke i krijuar kushte në kryerjen e veprës penale të vrasjes, në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjes pronësore me tani të ndjerin T.B., i cili ditën kritike së bashku me Z.K., dhe të akuzuarin P.Gj., ishin mbledhur të bisedojnë në odën e A.N., ashtu që i akuzuari P.. me të arritur tek shtëpia e të dëmtuarit A.. automjetin e tij të markës "...", me tabela të regjistrimit ..., e parkon pas automjetit të markës "S ." me tabela të regjistrimit ..., i cili ishte i të ndjerit T.B., që ishte i pakuar në drejtim të lumit ... në cilin drejtim nuk kishte dalje. Pasi nuk merren vesh mes veti, duke dal nga oda, i ndjeri T.B., ju kishte drejtuar me fjalët se "për këtë punë do të ju lajmërojë në Polici dhe Gjykatë", dhe kishte hipur në veturën e tij e kishte kthyer në drejtim të Gjakovës me qëllim që të lëvizte për të shkuar në shtëpinë e tij, ashtu që ishte ndalur dhe po priste dhe kishte kërkuar nga i akuzuari P... që ta largonte veturën e tij, pasi pjesa tjetër e rrugës ishte me baltë dhe ishte një kanal i hapur dhe nuk

kishte mundësi të lëvizte veturën e tij, i akuzuari me qëllim që ta pengonte lëvizjen e të ndjerit, nuk e largon veturën e tij të cilës ia kishte hapur derën e shoferit dhe po qëndronte aty, ngase ishte në dijeni se i akuzuari A...po vinte nga shtëpia, pasi që përmes numrit të telefonit, e kishte thirrur këtu të akuzuarin A.. duke e njoftuar dhe duke i thënë se “jam tek shpija e A.m.”, ku i akuzuari A... me atë rast e kishte marr pushkën automatike dhe kur arrin tek vendi i ngjarjes fillimisht gjuan në drejtim të automjetit tani të ndjerit, i cili pasi del nga automjeti për tu larguar gjuan në drejtim të tij duke i shkaktuar lëndime vdekjeprurëse dhe pas kryerjes të vrasjes, i akuzuari P...me automjetin e tij së bashku me të akuzuarin A.. largohen nga vendi i ngjarjes.

- **Me këto veprime ka kryer veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje nga neni 178 lidhur me nenin 33 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 21, 38, 39, 40, 42, 69, 70, 79, dhe nenit 178 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

- **ME DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej dhjetë (10) vite, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar me burgim prej datës 16.02.2021 deri me dt.13.01.2022, të cilin dënim do vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Të dëmtuarit K.B., V.M-B., dhe A.N., që të tre nga fshati ... Komuna e Gjakovës, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.
- **Detyrohet** i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej katërqind (400) Euro, si dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (30) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.26/2019, të datës 29.11.2021, kundër të akuzuarve A.GJ., dhe të akuzuarit P.GJ., që të nga fsh...., Komuna e Gjakovës, ku i akuzuari i dytë akuzohet për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje nga neni 178 lidhur me nenin 33 të KPRK-së.

Gjykata objekt shqyrtimi të kësaj çështje ka pasur në shqyrtim të akuzuarin e dytë P.GJ., për shkak të veprës penale të lartcekur duke marr parasysh vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës me numër Pml.nr.394/21 të dt.07.12.2021, pasi që i akuzuari i parë A.Gj., është gjykuar dhe dënuar me dënim me burgim unik në kohëzgjatje prej njëzet e dy (22) vite. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 12.02.2020, Prokurori i shtetit, kishte bërë precizimin e veprimeve inkriminuese të pikës IV të aktakuzës që ka bërë me të akuzuarin P.GJ., me arsyetimin ky precizim i veprimeve inkriminuese ka ardhur si rezultat i provave personale dhe provave materiale që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor

I akuzuari P.GJ., gjatë shqyrtimit gjyqësor edhe e rigjykim nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale nën pikën IV të aktakuzës (objekt shqyrtimi) për të cilën ngarkohet me akuzë.

Prokurorja e shtetit Ardita Beqiraj-Hyseni në fjalën përfundimtare ka deklaruar se fjalën përfundimtare e kam përpiluar në formë të shkruar në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët në procedurë, propozojë të jetë pjesë përbërëse e këtij procesverbali, të njëjtën do ta elaborojë para trupit gjykues (shih fjalën përfundimtare të përpiluar në formë të shkruar të bashkangjitur shqyrtimit gjyqësor të dt.26.02.2024).

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit V.B., av. Natal Bullakaj nga Suhareka në fjalën përfundimtare ka deklaruar se fillimisht e mbështesë fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit, mbesë pranë deklaramëve në fjalën përfundimtare të shqyrtimit të kaluar, edhe unë si përfaqësues fjalën përfundimtare e kam përpiluar në formë të shkruar në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët në procedurë, propozojë të jetë pjesë përbërëse e këtij procesverbali, të njëjtën do ta elaborojë para trupit gjykues. Shton se lidhur me kompensimin e dëmit do të parashtrijmë kërkesë pasurore-juridike në kontestin civil. (shih fjalën përfundimtare të përpiluar në formë të shkruar të bashkangjitur shqyrtimit gjyqësor të dt.26.02.2024).

I dëmtuari V.B., ka deklaruar se e mbështesë në tërësi fjalën përfundimtare të parashtruar nga ana e prokurores së shtetit dhe të përfaqësuesit tim, tjetër nuk kam se çka të shtojë. Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit A.N., av. Prek Kola nga Gjakova në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështesim në tërësi fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit, dhe të autorizuarit të palës së dëmtuar V.B., av. Natal Bullakaj.

I dëmtuari A.N., ka deklaruar se e mbështesë fjalën përfundimtare të parashtruar nga ana e prokurores së shtetit dhe të përfaqësuesit tim, tjetër nuk kam se çka të shtojë.

Mbrojtësi i të akuzuarit P.GJ., av. Salih Mekaj në fjalën përfundimtare ka deklaruar se edhe unë fjalën përfundimtare e kam përgatitur me shkrim, të cilën do ta paraqes si pjesë përbërëse e këtij procesverbali, dhe në pika sa më të shkurta do të përpiqem që të argumentojë se pse aktakuza e prokurorit të shtetit është e pabazuar. (shih fjalën përfundimtare të përpiluar në formë të shkruar të bashkangjitur shqyrtimit gjyqësor të dt.26.02.2024).

I akuzuari P.GJ., ka deklaruar se e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, dhe tjetër nuk kam se çka të shtojë.

2. Provat e administruara gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor

Meqenëse i akuzuari P.GJ., nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka administruar këto prova si: ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve - të dëmtuarit si në vijim: Dëgjimin e të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve A.N., V.B., Dëgjimin e dëshmitarëve SH.N., Z.N., J.GJ., T.G., Ka bërë leximin e deklaratave të dëshmitarëve të dhënë në shqyrtimet gjyqësore V.N., Z.K., L.B., leximin e provave materiale, siç janë : raportin e hetuesit H.L., me numër të ID...të datës 13.03.2019, raportin e oficerit N.RR., me numër të ID-KPS-8.i datës 12.03.2019, procesverbalin mbi kontrollin e personit dhe banesës i datës 12.03.2019, listën e armëve të sekuestruara nga i akuzuari A.GJ., i datës 12.03.2019, nga ana e oficerit G.L., raportin e oficerit G.L., me numër të ID... i datës 12.03.2019, raportin e oficerit M,G, me numër të ID... datës 13.03.2019, raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes me numër të rastit 2019-EA-243 i datës 12.03.2019, i përpiluar nga oficeri SH.Z., së bashku me tabelën e matjeve dhe skicën e pa shkallëzuar me datë të njëjtë dhe numër të njëjtë, raportin mbi ekzaminimin e veturës së viktimës T.B., nga Njësia e Teknikes Kriminallistike e datës 12.03.2019, të përpiluar nga hetuesi E.J., së bashku me foto albumin e bërë

gjatë ekzaminimi nga foto1 deri në foto 51, raportin e hetuesit H.S., i datës 18.03.2019, raportet e oficerit M.G., të datës 20.03.2019, 27.03.2019 dhe 01.04.2020, raportin e oficerit M.G., i datës 08.04.2019, raportin e ekspertimit të Agjencisë të Kosovës për Forenzikë me numër AKF/2019-0912/2019-798 i datës 23.04.2019, listungun e hyrjeve- daljeve për numrat e telefonave të cilët i shfrytëzonte i pandehuri P.Gj., dhe i pandehuri A.GJ., me datën 12.03.2019, raporti i ekspertimit të Agjencisë Kosovare për Forenzikë, me numër AKF/2019-0142 të datës 05.09.2019, që ka të bëjë me grimcat e barotit, raportet emergjente të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, me numër 4019 të datës 12.03.2019 në emër të të ndjerit viktimës T.B., raporti emergjent i Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë me numër 4020 të datës 12.03.2019 që ka të bëjë me të dëmtuarin A.N., raporti i ekspertizës së ekspertit mjeko ligjor Dr.D.H., i datës 05.06.2019, që ka të bëjë me të dëmtuarin A.N., raporti i autopsisë i Institutit të Mjekësisë Ligjore me numër MA-19-071 të datës 13.03.2019, i përpiluar nga Dr.M.G., , me të cilin është bërë autopsia e viktimës T.B., , shikimi i foto albumit të bërë nga Njësia e Teknikes Kriminallistike të datës 12.03.2019 nga foto 1 deri në 76 në 40 faqe, raportin e Njësisë Forenzike të Stacionit Policor në Gjakovë-mbi rikonstruimin e vendit të ngjarjes të bërë me datën 02.10.2020, i dorëzuar gjykatës me datën 12.10.2020, së bashku me foto albumin nga fotografia 1 deri në 40 në 21 faqe, fatura mbi tërheqjen e automjetit të tani të ndjerit T.B., të datës 08.04.2019 nga servisi “...”, fatura mbi tërheqjen e automjetit të akuzuarit A.GJ., të datës 12.03.2019, dëftesa mbi kthimin e pronës përkatësisht veturës që e kishte viktimë T.B., pronarit B.SH., të datës 08.04.2019, vërtetimi mbi lirimin e sendeve të sekuestruara nga viktimë T.B., i datës 12.03.2019, vërtetimi mbi lirimin e automjetit A.Gj., të datës 24.05.2019, vërtetimet mbi sekuestrimet e përkohshme të sendeve (setrave me ngjyrë të zezë të sekuestruara nga të akuzuarit P.GJ., dhe A.GJ.,) të datës 12.03.2019 nga oficeri E.J., , daljen dhe rikonstruimin e drejtpërdrejt të vendit të ngjarjes nga ana e gjykatës, si dhe ka dëgjuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit PreP.Gj.,

2.1. Deklarata e të dëmtuarve të dhënë në cilësi të dëshmitarëve

2.1.1 Dëshmitari – i dëmtuari **A.N.**, në ri shqyrtimin gjyqësor fillimisht ka deklaruar se mbesë në tërësi pranë deklarimit gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 25.06.2020, duke vazhduar me deklarimin e tij se atë ditë kam qenë në shtëpi, më ka thirr T.B., dhe më ka thënë se do të vie M... (vëllai i P...) për të biseduar për atë pronë, dhe e kemi pritun unë dhe T.. deri në orën 17:00/h për afërsisht 17:30/h, dhe na ka thirr në telefon M..i cili bisedojë me T.. ku ishim me një dhomë, dhe i ka thënë se kurrë gjë nuk kam mujt me bo vëllain P., dhe ka filluar me qajt në telefon, dhe i ka thënë T.. ndalu ta pijim nga një kafe dikund në qytet, dhe M.. i ka thënë, se jo-jo, jo dhe ka shkuar për Zvicër, T... mbas asaj e ka thirr Z.k., pasi që e ka pasur nipash ndërsa P. dajë, dhe i ka thënë në telefon, se a mundesh me shkuar tek P... me e pyet se çka po kërkon, pas gjysmë ore dikund na ka thirr Z...në telefon, dhe ka thënë se jam duke ardhur me P... në shtëpi tek unë, dhe unë mendova se po vjen mu marr vesh, kanë hyrë brenda, e kemi pirë nga një kafe, dhe kemi filluar bisedën rreth asaj prone, dhe Z.K., fillojë me biseduar me nipin e vet, i tha diçka që nuk i pëlqej këtij (P/. dhe u qun mu rreh në sobë teme dhe i ndava, T.. u prek dhe fillojë me dal, ku doli përjashta, unë u mundova me e ndal T.. për me biseduar edhe njëherë për mu pajtuar, kemi dal përjashta T.. ka dal i pari, unë kam dal mbas T... atëherë ka dal P.. dhe Z., ky e ka nxjerrë telefonin dhe e ka thirr djalin (A..) në atë tollovi nuk kemi mujt me e përcjell se çka është ka bisedon, veç e di se i ka thënë, hajde se jam tek A.M (pasi që baba im e ka emrin M...), dhe jemi dal jashtë dyerve të oborrit, në atë moment ka ardhur L.B., ai ka ardh pasi që e ka ditur se ku është T.. dhe L. e kemi kthyer për shtëpi pasi që nuk ka ditur asgjë se çka po ndodh. Nga dyert e oborrit i pari ka dal T.. mandej kemi dal rend që të gjithë, T... ka shkuar tek kerri i vet, e ka pasur me fytyrë kah D..., dhe kerri i P... ka qenë me fytyrë (pjesa e përparme) kah D..., kanë qenë si rend ndërsa Z... e ka pas më andej rrugës, mbi dyert e oborrit, dhe P.. ka ndejtë në telefon tek dera e kerrit nën stop dhe dera e kerrit ka qenë e hapur, ka qenë rrugë e ngushtë as 3 metra nuk ka qenë rruga, ka qenë e shtruar me

zhavorr që e kam shtruar unë me traktor, nuk ka qenë e asfaltuar, dhe në anën e epërme të rrugës ka qenë një vijë e ujit e gjerë 70 cm dhe e thellë 70 cm. P.. ka vazhduar që qëndrojnë tek automjeti i tij me derë të qelur vetura ka qenë e ndalur. Prej vendit ku ka qenë vetura e T.e me këtë gjendje të automjetit ku ndodhej automjeti i P...me derë hapur, T.. nuk ka mundur me kaluar veç me e kap kerrin në shpin, pasi që rruga e ngushtë, dera e hapur, nuk ka mundur. P... ka bërë thirrje vazhdimisht në telefon, mirëpo prej dyerve të oborrit kur ka ardhur kanë qenë në pyetje 3-4 minuta, kur ka ardhur djali i tij A.. i cili ka ardhur në këmbë me vrap dhe në dorë ka pasur armën kallash, P...e ka parë dhe i ka dal përpara dhe ka shkuar tek vetura e T... me të dhe ai ka filluar me gjuajt. Fillojë me gjujtë dhe unë shkova me i dal në ndihmë për me biseduar me të, dhe ai mu kthi në mua dhe më gjuajti mua në këmbë 4-5 fishekë, ku më ka kapur në këmbë pasi që tyta ishte e ulur, dhe më ka goditur me kondak të pushkës në ballë, dhe jam rrëzuar dhe T.. ka dal prej veturës, ka filluar me ik nga D..., dhe thuhet 3 metra është rrëzuar dhe A.. ka filluar me e gjuajt apër pasi ka dal prej kerrit, dhe janë kthyer dhe kanë hyp në kerri dhe kanë shkuar, nuk e di ku, ndërsa P..., asgjë nuk ka bërë, vetëm e ka përcjellë A....Sipas meje T.. ka pasur mosmarrëveshje me të dytë P... apo A.. për pronën, pozicioni i P... ka qenë në raport me A... dhe T...ka qenë tek dera e mbram e kerrit të T..A... ka qenë tek dera e parë kur ka gjuajtur me armë dhe P.. nuk ka marr veprime për me e ndaluar A..., ndërsa kur ka ardhur A...nuk kanë biseduar me P.... asgjë dhe A.. ka shkuar direkt te kerri dhe ka filluar me gjuajt. Kur ka ardhur A... automjeti i T... ka qenë i kthyer për Gjakovë pra nuk ka qenë më i kthyer me fytyrë nga D. por ka qenë i kthyer përpara nga rruga për me shkuar në Gjakovë, pasi që kur ka dal prej dyerve të oborrit menjëherë e ka kthyer automjetin, dhe automjeti i T... ka qenë i ndezur, por nuk ka pas kah me dal. Kerri i Z.,k., ka qenë në anën tjetër të rrugës, dhe Z.. është larguar me automjetin e tij para se me ardh A.i. Kishte filluar me ra terri, ku sipas meje ka mujt me u pa njeriu në 10-15 metra, kerri i T.. i ka pasur dritat e ndezura. P. as nuk ka biseduar me T..., pasi që është përta me dajën e vet, veç ka mujt me vet a je mirë dhe kaq, shton se gjatë bisedimeve se çka po donë prej meje, kur kanë biseduar këta është e vërtetë se nuk ka pasur tension apo fyerje në mes tyre, ai ka pasur problem me dajën e vet, pasi daja i tij i tha P.. që edhe babai i yt ka bo kësi sendesh në prona, ky nuk e durojë dhe u qu. Mbrojtja e ka ballafaquar me deklaratën e dhënë në gjyktë dhe në prokurori me pyetjen se a ka mujt T.me dal në drejtim të rrugës kryesore pa e larguar veturën P.. ku është përgjigjur nuk e di a ka qenë i larguar automjeti i Z..., por nëse ka qenë ka mujt. A është kjo e vërtetë çka keni deklaruar në prokurori? Dëshmitari ka deklaruar se nuk është e vërtetë as kjo. Me rastin e rikonstruimit të vendit të ngjarjes, i kam parë pozicionin se si janë vendosur automjetet, i P., i Z...i të ndjerit T...? Në anën e djathtë të fotografisë ka qenë vetura e P..., ndërsa në anën e majtë të fotografisë ka qenë vetura e Z..K... Rruga nuk ka qenë e asfaltuar pasi që ka qenë me zhavorr, ku tash kjo rrugë është 4 metra, pasi që është shtruar nga Komuna, atëherë ka qenë 3 metra a ka qenë a nuk ka qenë aq dhe ka qenë e shtruar me zhavorr, dhe ka qenë vija dhe kjo vi ka qenë në anën e majtë të fotografisë. Kur kam dal prej dyerve të oborrit kanë qenë të parkuara krahas veturat si në faqen nr.17 në foton 31. Dy vetura e P. dhe e Z... përafërsisht të ndaluara barabartë-krahas. Pasi që është larguar vetura e Z.. a ka mundur në këtë hapësirë këtu (duke ia treguar fotografimin e pyete) të kalojë T.. me veturë? Dëshmitari ka deklaruar se nuk ka mundur me kalu, sepse si e ka çelur derën Z.. ka ec. T. ka kërkuar, 2 herë Z. dhe P. që të ia lëshojnë rrugën. Ai ka hy në kerr dhe në ato momente ka ardhur A.. P. a e ka pasur derën e hapur të automjetit dhe ka qenë te automjeti. Shton se ka ardhur edhe L.B., dhe që të dy kanë dal prej automjetit dhe i ka thënë shko në shtëpi, dhe i njëjti është kthyer rikferc-mbas deri tek dera e vëllait tim. Nuk e ka lëvizur, qaty e ka lënë, P..automjetin kur ka dal nga shtëpia ime. Nuk e di se kush ka vozitur, pasi që kam qenë i plagosur, por e di që të dy kanë hyp në automjet.

2.1.1 Dëshmitari – i dëmtuari **V.B.**, në ri shqyrtimin gjyqësor fillimisht ka deklaruar se mbesë në tërësi pranë deklaramit gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 25.06.2020, duke vazhduar me deklaramin e tij se unë në atë kohë kam qenë në Zvicër dhe e kemi blerë tokën e A..., pastaj në krye të 2-3

muajve e ka thirre M..., vëllain T..dhe i ka thënë se kam dëgjuar që e ke blerë tokën e A.N.dhe vëllai i tha po, dhe pasi që e paske ble këtë unë po dua me ta shit edhe pjesën time që e kam nga teje, dhe vëllai i thotë, e për momentin nuk kam mundësi, por më vonë të njoftojë, dhe M. i tha për pare mos e le, pasi që e ke afër shtëpisë dhe mos e le, ajo ditë ka qenë e hënë, dhe i ka thënë se takohemi të dielën bashkë, dhe M... i ka interesuar me e ditë se sa e ka blerë arin prej A., dhe vëllai i thotë se e kam blerë 1.000,00 euro, dhe i thotë se aty për aty po ta bëjë përherë, vëllai i thotë merru vesh me vëllezërit, e pastaj folim, M. i ka thënë, se nuk kam se çka mu marrë vesh me askënd, pasi që është pjesë e imja, dhe vëllai prapë i thotë bisedo edhe një herë mirë se jemi kojshi dhe mos më qit telashe, me dhe M.. thotë se kurrfarë telashe, ti nuk ki punë me askënd, aty kanë qenë në pyetje 16 ari, ditën e diele të ardhshme është bërë pagesa dhe janë marrë vesh për tokën, mbasi është blerë toka pas 2 viteve, vëllai e ka pas një shok në .. dhe diçka me kqyr për qenë, dhe ai tha se po du me shku në Kosovë nja 2 ditë në J., ku kishte ardh të shtunën për tu kthyer të martën, dhe të dielën më tha se po këqyri me i hjek këto mexhë, me e rregull pasi që i kemi kryer pagesën, unë i thash mos hyn vet, merri nja 5 punëtor dhe i kryen shpejt e shpejt, ku njëri prej punëtorëve ka qenë K.H., ndërsa të tjerët nuk i kam njohur, kur kanë hy punëtorët me punuar në tokë P..ka shkuar me dy djemtë me armë me vete dhe e kanë ndaluar punën, dhe i ka thënë se mos punoni, se toka nuk është e jotja, vëllai iu thotë se unë e kam paguar tokën dhe merru vesh me M.. dhe vëllai nuk ka pas qef telashe, i ka hek punëtor, dhe aty për aty e ka thirr M..., dhe M... i ka thënë se vi nesër në orën 15:00/h dhe takohemi tek A.M., në orën 15:00/h e kam thirr unë, ishte A..duke e pritur M...ku unë kisha për të dal në punë, ku rreth orës 17:00/h e kam thirr, por nuk e qojke telefonin dhe kam filluar punën, ku pastaj pasa nja 1 ore 1.50 h më ka thirr L.B., dhe me thotë se kanë plagosur bacën T., kur pas disa minutave tjera e kam thirr në telefon por më njoftuan se ka vdekë dhe jam nisur për të ardhur në shtëpi. Rasti me punëtorët se janë penguar nga P. dhe djemtë e tij ka ndodhur një ditë para vrasjes së vëllait. M.. ka ardhur ditën kur ka ndodhur vrasja në Kosovë, ku pastaj kanë biseduar në telefon dhe ka thënë le këtë punë se bisedojmë më vonë se është situata e keqe. Jo në vendin e ngjarjes, më ka thirre në telefon por më vonë më ka thirre në telefon. Mbrojtja e ka ballafaquar dëshmitarin me deklaratën e dhënë gjatë atij shqyrtimit ku e ka pyetur se keni deklaruar se gjatë bisedës që keni pasur me vëllain tuaj, ai ju ka thënë se P.. me djemtë e tij A.. dhe M. e paska penguar që të vazhdojë me punën, A është e vërtetë kjo? Dëshmitari ka deklaruar se po është e vërtetë. Mbrojtja e ka pyet se në deklarinimin e sotëm ju thatë të njëjtën gjë vetëm se shtuat se djemtë e P. kanë qenë të armatosur. Pyetja ime është pse në shqyrtimin e kaluar nuk e keni përmendur faktin e armëve ndërsa sot po thuani se vëllai ju ka thënë se kanë qenë të armatosur? Dëshmitari ka deklaruar se kam mujt me harruar në atë kohë pasi që kam qenë në strese, mirëpo dëshmitarë kanë qenë gruaja ime dhe fëmijët e mi. Mbrojtja ju në dëshminë e dhënë në procesin e kaluar keni deklaruar se “P..së bashku me dy djemtë e vet A... dhe M...kanë shkuar me ja ndaluar punën, kurse vëllai T...iu kish thënë se nuk muj ta ndërprerje punën pasi që unë e kam blerë, ndërsa P... i kish thënë T...se unë ku të dush të betona se nuk kam punë me ty”, a është e vërtetë kjo çka keni deklarua? Dëshmitari ka deklaruar se po është e vërtetë.

2.2 Deklaratat e dëshmitarëve

2.2.1 Dëshmitarja **SH.N.**, në ri shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike, kam qenë në shtëpi ku ka ardhur ky zotëria-i akuzuari, T.. ka ardhur tek ne ka pas me u marrë vesh me vëllain e këtu të akuzuarit, por ai nuk ka ardhur, por ka ardhur i akuzuari dhe i kam dëgjuar duke u përparë me fjalë pasi që ne ishim në një dhomë tjetër dhe i kemi dëgjuar. Në odë të burrave përveç T.. dhe të pandehurit P.. ka qenë edhe Z.K., dhe biseda në odë ka qenë nja 20 minuta. Nuk i kam ndi se çka saktë kanë biseduar por i kam dëgjuar duke u përparë, duke bërtitur. Aty ka dal T.. dhe ka shkuar tek dyert e oborrit dhe i ka thënë se nuk kam punë me ju duke iu drejtuar të akuzuarit, ku i ka thënë se do ta rregullojmë me polici dhe me gjykatë, ku i ka thënë kthemi paret e mia dhe merre tokën pasi që nuk kam punë me ty. T.. ka dal i pari, pastaj i akuzuari i dyti dhe Z.K., i treti. Pasi

dolën jashtë, T..dojke me shkuar por i akuzuari nuk ia lëshojke rrugën ia ka zënë kerrin. T.. e ka pasur kryet e kerrit të kthyer nga D., pastaj hypi në kerr e kthejë dhe thojke lëshoma rrugën të akuzuarit P.GJ., pasi që i akuzuari e kishte kerrin në rrugë. I akuzuari rrinte në telefon duke folur, ku nuk ka vonuar shumë e ka ardhur djali i tij me automat, ndërsa ky e linte derën e kerrit të çelur dhe rrinte te kerri. Nuk e kam dëgjuar por dihet se me kënd ka folur me djalin e vet, pasi që dy tri herë ka folur. Prej momentit kur kanë dal prej odës e deri te dera, e deri sa ka ardhur A..., ndoshta ka zgjat 5 minuta për afërsisht, s'po di. Automjeti i T.. ka qenë i ndezur automat dhe T. pasi që e ka ndezur kerrin e ka kthyer dhe ka dal pastaj jashtë duke thënë lëshomani rrugën dhe kur ka ardhur me automat (A..) ka hyrë brenda në automat. Kur A..i erdhi, P.. ka qenë tek kerri i vet, ky (A..) ka ra përskaj të tij duke shajtur T.. dhe pastaj i ka mëshuar automat dhe nuk ka tentua mi ndal hiq. Kerri i të akuzuarit këtu ka qenë i kthyer me krye kah D., pastaj e ka kthyer kur ka ndodhur rasti (vrasja), ndërsa për A... nuk e di a ka shkuar me automat apo si pasi që unë kam vajtur brenda për të kërkuar ndihmë. T... kur e ka kthyer automat nuk ka pasur shanse me dal me automat pasi që ka qenë lloqë (balt), e nuk ka qenë qysh është sot e asfaltuar, pasi që ka qenë një vijë e ujit, e me pas tentuar me dal kishte ra në vijë të ujit. P. ka pasur derën e automatit të hapur gjatë gjithë kohës. Kur e kam ndi preken tu fol në telefon ka ardhur A.. për 5-6 minuta më tepër nuk ka pas, shtëpia e P.. prej shtëpisë sonë është 5 minuta mirëpo pas sqarimit të gjykatës lidhur me distancën e njëjta nuk dinë ta përshkruaj distancën mirëpo merr shembull objektin e gjykatës me postën në Gjakovë, dhe thotë se distanca është më e afërt. Kur A.. ka gjuajtur ka shtënë në drejtim të T.. dhe bashkëshortit tuaj, P... në këtë situatë nuk ka bërë asgjë, vetëm i rrike mbas. Dhe pas gjuajtës qaty ka ndjejt. T.. ka qenë duke e pritur M..-vëllain e të akuzuarit, i cili nuk ka ardhur atë ditë në odën tonë. Kta kanë qenë në një dhomë ndërsa unë kam qenë kujshi dhomës dhe i kam dëgjuar duke bërtitur T..Z..dhe P..., ndërsa ky më shumë pasi që iu dëgjojke zëri. Kam shkuar edhe unë tek dyert e oborrit dhe jashtë derës së oborrit kam dal në skajtë, ka qenë edhe një veturë e kushërinjve (ndamëve) të tij, por ai ka shkuar më herët me veturë, ndërsa ka qenë automat T.., P.. dhe Z... L. nuk ka qenë brenda në shtëpi, ka ardhur tek dyert dhe ka shkuar. Vetura e Z.. nuk më kujtohet se si ka qenë por ka qenë pas veturës së P...Nuk e kam dëgjuar se çka ka biseduar P. por e di se ka folur në telefon. Mbrojtja e ka ballafaquar se me deklaratën e dhënë në prokurori keni deklaruar se keni dëgjuar P.. duke biseduar në telefon dhe i ka dëgjuar fjalët se jemi tek shtëpia e A..M. (N.), a është e vërtetë kjo? Dëshmitarja ka deklaruar se ndoshta e kam thënë, por nuk po di , nuk po më kujtohet. Më afër dyerve tona ka qenë vetura e T.. pastaj e P. dhe e Z.. KTGJ ka pyet dëshmitaren dhe ia ka jap në shikim fotografën e renditjes së automjeteve të bërë me rastin e daljes në rishikim të vendit të ngjarjes, ku e njëjta e përshkruan ku pas shikimit në fotografën me ngjyra të këtij raporti 17/21 në foton 1 me nr.31? Dëshmitari e përshkruan se nuk ka qenë kjo renditje, pasi që automat i T.. ka qenë i pari, pastaj i P. dhe pastaj i Z..

2.2.2 Dëshmitari **Z.n.**, në ri shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike, kam qenë në stallën time të lopëve dhe kam dëgjuar krismat, ku prej stallës deri tek vendi i ngjarjes sa është dikund nja 30 metra, ndërsa kam dëgjuar vetëm krisma, kur kam dal e kam gjetur vëllain A... të plagosur, dhe i kam thënë se çka u bë, ai më tha se A.GJ., më ka lënduar, prezentë aty ishte Sh.. dhe V., nja 5-6 metra larg vëllait ka qenë T. i shtrirë, pasi që vëllai më tha lërmë mua se T. është keq. Kerri i T. ka qenë i ndezur, në drejtim të Gjakovës dhe dera e shoferit ka qenë e çelur. Unë e kam dërguar T.. dhe A... në spital me një automat, nuk kam parë askënd duke u larguar apo ndonjë automat duke u larguar vetëm siç e shpjegova më lartë.

2.2.3 Dëshmitarja **J.Gj.**, në rishqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike, unë kam qenë në shtëpi, P.. ka qenë në shtëpi, edhe A..k., ka qenë në shtëpi, ka ardh Z.K., , pasi që i tha burrit hajde me shkuar për me u marrë vesh tek A.. mu marrë vesh me A... dhe T.., burri i tha, se unë me T.. jam marrë vesh, veç po vi po i ngoje fjalë, M. a ka qenë atë ditë orën nuk e di por ka qenë paradite dhe ka pirë një kafe, kanë biseduar dhe P.. i tha mu marrë vesh për këtë çështje, ndërsa M..tha mu

marrë vesh me burra. P.. ka biseduar me A...për punën se qysh mu marrë vesh me M... Kur ka ndodhur rasti unë kam qenë në oborr, duke vaditur lulet, kam dëgjuar piskamë dhe bërtim. Veç zëra janë ndi, zërat kanë ardhur prej së poshti, kam hy brenda dhe i kam thënë djalit se kam dëgjuar një piskam prej së poshti, e daja Z.. e ka marrë babën e kanë shkuar tek A.. Nuk kam ndi por telefonin djali e ka pasur në dorë. Është quar si i habitur, ka marrë armën dhe ka dal përjashta, unë i thashë, e ku po shkon djali i jam, ai si i hup ka dal, pa thënë asgjë, ka dal si i huptë. Po, çika më tha se krisi diçka poshtë, pastaj ka ardhur burri dhe tha mozamakeq sa çka u bo, pastaj kanë ardhur policia dhe u mbush soba dhe nuk më ka ra me biseduar më gjatë me te. A.. a ka qenë në gjumë. Është e vërtetë se në procesverbalin e datës 14.10.2020 të dhënë në gjykatë, kam deklaruar se keni pasur në plan për të shkuar tek motra e P.. Kur kam hy unë në dhomë, A.. u qu dhe unë i thashë se daja Z... e ka marrë babën dhe kanë shkuar tek A. dhe po ndihet një bërtitme dhe ai e ka marrë armën dhe ka dal si i hutuar. Shtëpia e jonë prej shtëpisë së A..., distancën nuk e di saktë por një kodër e kemi në mes.

2.2.4 Dëshmitari **T,G,**, në rishqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se me të pandehurin P..njihemi pasi që kemi kumari dhe ndiqemi familjarisht dhe kemi raporte të mira, për çështjen e pronës me mua personalisht jo nuk ka biseduar, pasi që asnjëherë nuk kam qenë kur është biseduar lidhur me këtë tokë, veç e di se e kanë pasur një mosmarrëveshje. Unë nuk di lidhur me rastin se si ka ndodhur, por mu më ka thirr A...dhe e kam dorëzuar në polici dhe tek shtëpia a kemi biseduar në telefon me policin dhe pasi që është përshëndetur me familjen. Kur kam shkuar tek shtëpia e A.. ka qenë P.. në shtëpi. P., kanë qenë të mërzitur ky dhe familja dhe nuk kam biseduar pasi që kanë qenë policia. Në fsh.. kur e kam takuar A...ka qenë në këmbë, dhe më ka thënë se kam ardhur në këmbë, e ka pas armë të gjatë garant ka qenë kallash. Me avokatin Ndrec Dodaj ka biseduar ne telefon dhe me policinë për me u dorëzuar, me P.. nuk mendojë se ka biseduar pasi që kam qenë i stresuar.

2.2.5. Dëshmitarja – **V.N.,**, lidhur me procedimin e kësaj dëshmitare në pamundësi të sigurimit të prezencës së saj dhe pajtimin e palëve është lexuar deklarata e saj e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor e cila kishte deklaruar se me datë 12.03.2019 pasdite kam qenë në shpi. Më kujtohet kanë ardhur mysafir fillimisht ka ardhur T.B., por orën nuk e di saktë por e di që ka qenë mbas dite dhe pastaj më vonë ka ardhur P.GJ., me Z.K.,. Ata kanë qëndruar në odë, ndërsa ne kemi qëndruar në një dhomë tjetër me gruan e babës dhe me djalin e motrës dhe unë kam hyrë në odë vetëm kur i kam shërbyer me kafe. Ajo ka theksuar se kam dëgjuar bisedën në mes të T.. duke thënë se “unë u mundova me e zgjedhë me të mirë por meqenëse ju nuk po doni tash kam me e zgjedh me polici dhe me gjyq”. Nga oda së pari ka dal T...pastaj ka dal P..., Z.. si dhe baba im A.N.. T. ka hyp në veturë dhe e ka kthye veturën për me shku dhe Pr... dhe Z..i kanë pasur kerret në rrugë dhe T.. nuk ka pasur kah me dal ngase rruga u kanë e pa ndreqën dhe ka qenë shumë lloç dhe T.. e ka ndez veturën, e ka lanë ndezë dhe iu ka thënë këtyre lëshomani rrugën të shkoj. P. e ka qel derën e veturës së tij dhe i njëjti nuk ka hyrë asnjëherë në veturë por ka ndjetë jashtë, u sillte rreth veturës dhe ka fol me dikën në telefon dhe i ka thënë “jam tek shpija e A.M.,”. Kam qëndruar aty mundem edhe 4 minuta dhe pastaj e kam marr djalin e motrës dhe kam hyrë brenda. Nuk ka kaluar as 1 minutë prej kur kam hy brenda, atëherë i kam dëgjuar krismat. Kur kam dal jashtë përveç A.. dhe T..., nuk kam parë askënd pra nuk ka pas persona tjerë, nuk i kam parë P... dhe A..., por e kam parë babën që ka qenë i ulur në tokë dhe e kam parë që ka pas gjak në fytyrë dhe në këmbë dhe kur jam ofruar afër më ka thënë “lemë mu se jam mirë por shko tek T..”. T.. nuk e kam parë se ka qenë terr dhe pastaj e kam ndez dritën e telefonit jam ofruar dhe T.. e kam parë të shtrirë në shpin dhe sytë i ka pasur të mbyllur por merrke frymë ende. Tek pjesa e barkut tek rripi i pantallonave tek T.. kam parë shumë gjak. Vetura e Tu... ka qenë e ndezur dhe kur kam dal e kam parë që dera e veturës së T.. ka qenë qelë pra dera e shoferit. T.. ka qenë larg automjetit të tij rreth 3-4 metra. Pastaj në vendin e ngjarjes ka ardhur axha Z. dhe po ashtu kanë ardhur edhe djemtë e axhës më vonë. Ajo ka shtuar se kur ka ardhur axha kemi dashtë me e thirr ambulancën por e pashë që nuk kishte kohë

për ambulancë ngase T... ishte në gjendje të keqe, i thash axhës se po e qesim T.. në kerr të vetin meqenëse ishte ndezur dhe dërgoje ti në spital dhe i kemi ndihmuar axhës unë, gruaja e babës Sh..., për me vendos T.. në veturë. E kemi vendos në veturë pastaj kanë ardhur djemtë e axhës dhe i kanë ndihmuar babës për me e fut në veturë dhe pastaj axha i ka dërguar në Spital. Kur T... e ka kthyer veturën për në drejtim të Gjakovës e kam parë personalisht dhe se T.. nuk ka mund me dalë për shkak se veturat kanë qenë në rrugë dhe pjesa tjetër ka qenë shumë lloç dhe nuk ka mund me kalu.

2.2.6 Dëshmitari **L.B.**, lidhur me procedimin e këtij dëshmitar në pamundësi të sigurimit të prezencës së tij dhe pajtimin e palëve është lexuar deklarata e tij e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor i cili kishte deklaruar se me datën 12.03.2019 kam qenë tek S.GJ., në .., duke rregulluar veturën dhe atëherë duke u kthyer për shtëpi e kam parë veturën e bacës T.. tek dyert e A.. dhe kam shkuar aty kam zbritë prej veture dhe ora saktë nuk më kujtohet por ka qenë duke u terrua pra pak para vrasjes. Pasi që kam zbritë prej veture, ka ardhur baca T... dhe Z.K., dhe më ka thënë hyp në veturë se e kemi rregulluar punën dhe duke hyp në veturë e kam dëgjuar P.GJ., duke i thënë dikujt “hajde” dhe se me kënd ka qenë duke fole nuk e di. Kam vazhduar për në shtëpi, sapo kam hyrë në oborr pasi që kam dalë nga vetura e kam dëgjuar krismën dhe menjëherë kam shkuar në vendin e ngjarjes por aty ka pas shumë njerëz. Nuk e kam parë as bacën T.. as A..., as P.. dhe as Z.Ai ka shtuar se në momentin kur kam shkuar për herë të parë në vendin e ngjarjes nuk kam dëgjuar ndonjë zhurmë apo ndonjë tension në mes të personave që kanë qenë prezent çdo gjë e qetë. Ai ka theksuar se T....atë natë nuk më ka thënë asgjë për tokën por më ka thënë shko në shtëpi ti se çdo gjë është në rregull, nuk më ka thënë asgjë.

2.2.7. Dëshmitar – **Z.K.**, (tani i ndjerë), lidhur me procedimin e këtij dëshmitar në pamundësi të sigurimit të prezencës së tij pasi që i njëjti ka ndërruar jetë është lexuar deklarata e tij e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor i cili kishte deklaruar se me datën 12.03.2019, kam qenë në fshatin pikërisht në shtëpinë e P.GJ., dhe se kam shkuar me kërkesën e T.B., i cili ka më ka kërkuar që të shkoj tek P.GJ., që ti them “çka kërkon ti prej meje se unë parët i kam la”. Duke shkuar tek shpija e P... T.. B.. më ka thirr në telefon tek dera e shtëpisë dhe më ka thënë “thuj P... se nëse donë hajde tek A.N., që të merremi vesh”. Tek shtëpia e P... kam shkuar rreth orës 15:00/h dhe aty në dhomën ku rrinë kanë qenë vetëm P.. dhe bashkëshortja e tij. A... nuk ka qenë prezent. Pasi kam shkuar tek P.. i kam thane se duhet me u marr vesh. P... më tha se i ka fajet vëllai jem M... që e ka shit tokën pa më pyetur mua. Ai ka shtuar se pasi jam dalë nga shtëpia e P. jemi nisë për në shpinë e A.. rreth orës 16:00/h ose 17:00/h, nuk më kujtohet saktë, kam shkuar me veturën time, ndërsa P... me veturën e tij, P... ka shkuar para meje dhe pas tij. Kur kemi shkuar tek shpija e A.. aty ka qenë T.B., dhe A.N.,. Ai ka shtuar se T... ka kërkuar nga P..., me u rregulluar kjo punë për shkak se tokën e kishte blerë dhe i kishte paguar paratë dhe kërkuar që mos me pengu me shfrytëzua tokën. Ne aty nuk u morëm vesh për shkak se P... thojke se “i ka fajet vëllai jem M.. që ia ka shitë pa e vetë hiq”, pasi që edhe P... kishte pas hise në atë tokë. Meqenëse nuk u morëm vesh T.. tha se këtë punë e lajmë për gjykatë. Biseda që është zhvilluar në odën e A... ka qenë bisedë normale e qetë dhe pa përllarje dhe sharje. Kur kemi dal nga oda kemi dal gati si grumbull, meqenëse T... tha se këtë punë e lëmë për gjykatë, kam kërkuar me shku në shtëpi. Jashtë dyerve është fole A., ka kërkuar edhe një herë me hy e me u marr vesh dhe daja T... thojke jo se e lajmë për gjykatë dhe kur ai tha kështu unë veç kam hyp në veturë, e kam ndez dhe kam ec. Ai ka shtuar se para se të nisem për në Gjakovë, vetura e T...ka qenë me krye kah Gjakova, veturat kanë qenë shumë afër dhe se ka qenë shumë lloç dhe se nuk kemi mund me lëviz. T.. pa e larguar P... veturën nuk ka mund me ecë ngase ka qenë bukur zor për shkak se ka qenë lloç. Ai ka shtuar se kur jam larguar me kerr aty i kam lënë këta të tretë T..., A... dhe P..... Situata nuk ka qenë e tensionuar ngase të po të kishte qenë situata e tensionuar unë nuk isha larguar. Ai ka shtuar se kam hyrë në veturë dhe jam nisë për në Gjakovë, ngase T... thojke veç për gjykatë pastaj eca me veturë dhe skam ecë as 20-30 metra prej vendit të ngjarjes veç kur e kam dëgjuar krismën e armës dhe në pasqyre të veturës e

kam parë edhe flakën e armës, krismat kanë qenë “ding, ding” i kam gra veturës deri tek shpija e V.- vëllait të A..N., E kam parku veturën para dyerve të shtëpisë së tij, kam dalë dhe kam shkuar atje dhe i kam parë të shtritë A... dhe T.B., kanë qenë edhe familjarë të N.... T... ka qenë i shtrirë afër veturës, A... ka qenë pak më lartë dhe gjërat tjera nuk më kujtohen ngase kam humbur krejt ngase P., e kam pasur nip, ndërsa T... djalë të dajës.

2.3 Provat materiale

2.3.1. Nga leximi i raporti i hetuesit H.L., me numër të ID., të datës 13.03.2019, gjykata ka konstatuar se në këtë raport janë përshkruar veprimet hetimore që ka ndërmarr oficeri H.L.,

2.3.2. Nga leximi i raportit të oficerit N.RR., me numër të ID-KPS-..., i datës 12.03.2019, gjykata ka konstatuar se në këtë raport janë përshkruar veprimet hetimore që ka ndërmarr oficeri N.RR., në të cilin theksohet se rreth orës 20:30 minuta deri sa po vazhdonim në kërkimet për të dyshuarin në shtëpinë dhe objektet tjera përcjellëse të shtëpisë është arrestuar i dyshuari kryesor A.GJ., i cili është vetë dorëzuar pranë policëve dhe i njëjti a dorëzuar armën e përdorur në kryerjen e veprës.

2.3.3. Nga leximi procesverbali mbi kontrollin e personit dhe banesës i datës 12.03.2019, gjykata ka vërtetuar se bastisja ishte bërë me datën 12.03.2019 në shtëpinë e të akuzuari A.GJ., pronë e këtu të akuzuarit P.GJ., ku si dëshmitarë gjatë bastisjes kishin qenë M.GJ., dhe B.N., ashtu që gjatë bastisjes në procesverbal është konstatuar se nga pronari P.GJ., është dorëzuar një pushkë gjuetie me nr.#57626 me rrethanor dhe 14 fishekë, të kalibrit 12 mm. Bastisja kishte përfunduar në ora 21:00/h.

2.3.4. Nga leximi i listës së armëve të sekuestruara të datës 12.03.2019, nga ana e oficerit G.L., gjykata ka vërtetuar faktin nga ana të akuzuarit A.Gj., ishte sekuestruar një (1) pushkë gjysmë automatike, me numër serik: 10232508, së bashku me një (1) karikator dhe pesëmbëdhjetë (15) fishekë, të kalibrit 7.62x39mm.

2.3.5. Nga leximi i raporti i oficerit G.L., me numër të ID-9685 i datës 12.03.2019, gjykata ka konstatuar se në këtë raport janë përshkruar veprimet hetimore që ka ndërmarr oficeri G.L.,

2.3.6. Nga leximi i raporteve të oficerit M.G., me numër të ID:1013, të datave: 13.03.2019, 20.03.2019, 27.03.2019, 01.04.2020 dhe 08.04.2019, gjykata ka konstatuar se në këto raport janë përshkruar veprimet hetimore që ka ndërmarr oficeri M.G.,

2.3.7. Nga leximi i raportit të këqyrjes së vendit të ngjarjes të oficerit SH.Z., me numër të rastit 2019-EA-243 i datës 12.03.2019, së bashku me tabelën e matjeve dhe skicën e pa shkallëzuar me datë të njëjtë dhe numër të njëjtë, gjykata ka vërtetuar faktin se njësia e forenzikës ditën kritike kishe dal në vendin e ngjarjes, ku fillimisht kishin shkuar në Spitalin Rajonal “Isa Greda” në Gjakovë, meqenëse viktima T.B., dhe i dëmtuari .A.N., ishte dërguar në emergjencë, ashtu përmes këtij raporti shihen fotografimet e viktimës dhe dëmtuarit dhe po ashtu konstatohet janë marrë dëshmitë e evidentuara nga nr.1 deri në nr.3. Pastaj në ora 20:30 minuta të njëjtit kishin shkuar në vendin e ngjarjes në fshatin, ku shihet kishin bërë fotografimin e vendit të ngjarjes dhe shihen gjurmët të gjetura, të cilat janë evidentuar dëshmia nga nr.4 deri nr.19. Në ora 21:50 minuta kishin përfunduar me vendin e ngjarjes ashtu që me të kthyer në stacion të njëjtit kishim marrë edhe dëshmitë të cilat janë evidentuar nga nr.20 deri nr.21. Gjithashtu me datën 18.03.2018 janë gjetur edhe dëshmitë të cilat janë evidentuar nga nr.25 deri nr.28. Të njëjtit kanë bërë edhe matjet fikse të gjurmëve të gjetura në vendin e ngjarjes të cilat kanë evidentuar në tabelë të matjeve dhe të njëjtat janë vendosur edhe në skicë.

2.3.8. Nga leximi i raportit të hetuesit E.J., mbi ekzaminimin e veturës së viktimës T.B., nga Njësia e Teknikës Kriminallistike e datës 12.03.2019, së bashku me foto albumin nga nr.1 deri nr.51 të bëra gjatë ekzaminimit, gjykata ka vërtetuar faktin se vetura e viktimës T.B., ishte goditur me armë zjarri tek dera e parë e shoferit në anën e majtë dhe në pjesën e pasme të njëjtës anë, ashtu që shihen nëntë (9) vrimat të cilat janë evidentuar me numra dëshmues nga 1 deri në 9 tek dera e parë e shoferit dhe një (1) vrimë në pjesën e pasme që evidentuar me numra dëshmues 10. Po ashtu është vërtetuar se brenda në veturë në dysheme pas ulëses së shoferit është gjetur një predhë që është evidentuar me numra dëshmues nga 11. Po ashtu pas ulëses së pasagjerit në dysheme është gjetur një pjesë e kmishëzës së predhë që është evidentuar me numra dëshmues nga 12. Në pragun e derës së përparme shihen gjurmë gjaku. Po ashtu ulësja e parë e shoferit shihet e dëmtuar nga predhat. Po ashtu në pjesën e pasme të kësaj veture ku kishte qenë i shtrirë viktimia deri në spital shihen gjurmët e gjakut “pellg gjaku”.

2.3.9. Nga leximi i raportit të hetuesit H.D., i datës 18.03.2019, gjykata ka konstatuar se në këtë raport janë përshkruar veprimet hetimore që ka ndër marr oficeri H.S.,

2.3.10. Nga leximi i raportit të ekspertimit të Agjencisë të Kosovës për Forenzikë me numër AKF/2019-0912/2019-798 i datës 23.04.2019, gjykata ka vërtetuar faktin është bërë ekzaminimi i armës të cilin janë kryer veprat penale si dhe i predhave dhe gëzhjojave që janë gjetur në vendin e ngjarjes. Dëshmitë të cilat janë evidentuar me shifrën # 9, 10, 13, 14, 15, 16, 18, 19, 25, 26, 27 dhe 28, janë dymbëdhjetë (12) gëzhjoja, pjesë të fishekëve të kalibrit 7.62x39mm. Ato janë shkrepur nga pushka automatike e cila është e evidentuar me shifrën nr#22 e cila është një (1) pushkë, automatike Type-68, të cilin armë e kishte dorëzuar i akuzuari A.GJ., me rastin e dorëzimit të tij në shtëpinë e tij para Policisë.

2.3.11. Nga leximi i vërtetimit mbi lirimin e sendeve të sekuestruara nga viktimia T.B., i datës 12.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se sendet personale që kanë qenë të sekuestruara nga viktimia me datën 14.03.2019, janë kthyer familjarit-vëllait V.B.,

2.3.12. Nga leximi i vërtetimit mbi sekuestrimet e përkohshme të sendeve të datës 12.03.2019 nga oficeri E.J., gjykata ka vërtetuar faktin se nga të akuzuarit P.GJ., dhe A.Gj., janë sekuestruar dy setra me ngjyrë të zezë, të cilët i kanë pasur të veshura në momentin e kryerjes së veprave penale.

2.3.13. Nga shikimi listingut të hyrjeve-daljeve nga listat e PTK-së, për numrat e telefonave dhe atë: 045-215-641 të cilin e shfrytëzonte i akuzuari A.Gj dhe të cilin e shfrytëzonte i akuzuari P.Gj., gjykata ka vërtetuar faktin se të akuzuarit përmes numrave të telefonit të lartë cekur gjatë ditës me datën 12.03.2019 nga ora 09:59 minuta deri në kohën kur janë kryer veprat penale në ora 18:35 minuta kishin pasur kontakt telefonik pesëmbëdhjetë (15) herë. Ashtu që nga këto thirrje natën kritike, 5 minuta para se të ndodhë rasti, kishin komunikuar përmes telefonit tre (3) herë dhe atë: 18:24, 18:25, 18:35 minuta.

2.3.14. Nga leximi i raportit të ekspertimit të Agjencisë Kosovare për Forenzikë, me numër AKF/2019-0142 të datës 05.09.2019, që ka të bëjë me grimcat e barotit, gjykata ka vërtetuar se nga dëshmitë #1 dhe #2 që dy setra me ngjyrë të zezë që janë sekuestruar nga të akuzuarit, nuk janë evidentuar prani e nitrateve dhe nitrateve të cilat janë të pranishme edhe të mbetjet e qitjes me armë zjarri me prejardhje nga barutet. Po ashtu në tubin (disku) objekt ekspertimi nga dëshmia #3, #4, #5 dhe #6, që janë marr nga duart e të akuzuarit A.Gj., nuk janë evidentuar mikrogrimca unike përmbajtje të tre elementeve kimike me prejardhje nga kapsolla e armës së zjarrit. Mirëpo

në raport konstatohet se mungesa e mbetjeve të grimcave me prejardhje nga kapsolla e armës në duart e një personi nuk e eliminon atë person nga mundësia e shkrëpjes (zbrazjes) së në arme zjarri.

2.3.15. Nga leximi i raportit emergjente të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, me numër 4019, të datës 12.03.2019 në emër të ndjerit-viktimës T.B., gjykata ka vërtetuar se faktin se në ora 18:50 minuta kur ishte dërguar në spital viktima T.B., kishte qenë pa shenja jete, të cilin gjendje e kishte konstatuar Dr. SH.D.,.

2.3.16. Nga leximi i raportit emergjent i Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë me numër 4020 të datës 12.03.2019 që ka të bëjë me të dëmtuarin A.N., gjykata ka vërtetuar faktin se i dëmtuari A.N., është trajtuar për shkak të lëndimeve në këmbë dhe në kokë.

2.3.17. Nga leximi i raportit të ekspertizës së ekspertit mjeko ligjor Dr. D.H., i datës 05.06.2019, gjykata ka vërtetuar se i dëmtuarit A.N., ka pësuar lëndime edhe atë: plagë nga arma e zjarrit në të dy kërcirit e majtë si dhe plagë shqyese në regjionin e vetullës së djathtë, të cilat lëndime me besueshmëri janë të shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së hedhur nga arma e zjarrit dhe veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë) dhe të cilat bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore.

2.3.18. Nga leximi i raportit të autopsisë i Institutit të Mjekësisë Ligjore me numër MA-19-071 të datës 13.03.2019, i përpiluar nga Dr. M.G., me të cilin është bërë autopsia e viktimës T.B., gjykata ka vërtetuar se vdekja e të ndjerit T.B., është jo e natyrshme dhe ka ardhur si rezultat i gjakderdhjes masive në hapësirën e lirë të kavitetit adobominal, pas shqyerjes së arteries dhe venës formale të djathtë, si pasojë e veprimit dinamik të predhës së armës së zjarrit.

2.3.19. Nga leximi i raportit të Njesisë Forenzike të Stacionit Policor në Gjakovë-mbi rikonstruimin e vendit të ngjarjes të bërë me datën 02.10.2020, i dorëzuar gjykatës me datën 12.10.2020, së bashku me foto albumin nga fotografia 1 deri në 40 në 21 faqe, gjykata për të vërtetuar në mënyrë sa ma të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, si dhe për të pasur një vlerësim sa ma real të provave, trupi gjykues së bashku me Prokurorin e shtetit, të dëmtuarit, përfaqësuesit e palëve të dëmtuara, të akuzuarit dhe mbrojtësit e të akuzuarve si dhe me zyrtarët policor nga Njësiti i Forenzikës, me datën 02.10.2020, kanë dal dhe kanë bërë rikonstruimin e vendit të ngjarjes në fshatin Komuna e Gjakovës përkatësisht para dyerve të shtëpisë së të dëmtuarit A.N., Zyrtarët policor të Njesisë së Forenzikës, fillimisht kishin vendosur shenjat përkatësisht pikat e gjurmëve që janë gjetur natën kritike me datën 12.03.2019, të njëjtit kanë bërë fotografimin e vendit të ngjarjes si dhe matjen e disa pikave të caktuara në vendin e ngjarjes, që janë konstatuar në procesverbalin mbi rikonsruimin e vendit të ngjarjes të datës 02.10.2020 dhe në raportin e lartshënuar.

2.3.20. Nga shikimi i foto albumit të bërë nga Njësia e Teknikes Kriminalistike të datës 12.03.2019 nga foto 1 deri në 76 në 40 faqe, gjykata ka vërtetuar se në këto fotografi shihen gjurmët që janë gjetur në vendin e ngjarjes natën kritike e po ashtu shihet edhe viktima dhe i dëmtuari në Spitalin “Isa Grezda në Gjakovë.

2.3.21. Nga leximi i faturës mbi tërheqjen e automjetit të tani të ndjerit T.B., të datës 08.04.2019 nga servisi “...”, i faturës mbi tërheqjen e automjetit të akuzuarit A.GJ., të datës 12.03.2019.

Gjykata konsideron se këto prova edhe pse të administrua kanë qenë irelevante për këtë çështje pasi që provat e nxjerra kanë qenë prova që kanë të bëjnë më të akuzuarin e parë A.GJ., tani i

gjykuar, prandaj nuk bërë vlerësim të tyre të veçantë, mirëpo do të analizojë provat që lidhen me të akuzuarin P.GJ.,

2.4 Mbrojtja e të akuzuarit

2.4.1 I akuzuari P.GJ., gjatë shqyrtimit kryesor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet ndërsa në ri shqyrtimin gjyqësor në mbrojtën e tij ka deklaruar se atë ditë para ditës kritike kur kam shkuar në livadh, T...ka qenë aty, dhe nja 4 a 5 të Deçanit edhe u kam thënë puna e mbarë, mbarë paq, a ju ka thënë gjë ky kojshia dhe mik, ata më thanë, jo, unë iu thash se këtu është me problem se vëllai nuk na ka pyetur, se ne jemi tre vëllezër dhe ja ka shitur T..., të merremi vesh ne vëllezërit dhe nëse i bie vëllait, le të ia fal le të bëjë çka të donë, atëherë T. ka thënë se unë e kam blerë se nuk më ka lënë vëllai me e qel rrugën, unë i kam thënë se pse nuk ke ardh si kojshi e mik, se unë 4 metra ti kisha lëshuar pa i pyetur vëllezërit e askënd, i kam thënë se këto 20 ari ia kam thënë axhës, e axha nuk ka ardh me e ndreq vendin këtu, pra siç e thash se kur të merremi ne vëllezërit vesh, në i raft atij le ta fal e të bëjë çka të dojë. Ka ardhur daja-Z.K., dhe tha, se më ka qarur T...për me të thirre e me shkuar me u marr vesh, ndërsa unë i thash dajës se na jemi marr vesh me T.. dhe pasi që të merremi vesh ne vëllezërit, dhe ai më tha, me ardh se është ka të pret T..., ka qenë gruaja dhe vajza. Kemi shkuar te T.. secili me veturë të vetën, ka qenë kerri i T.. aty, pastaj kam mbërri unë pastaj daja përmbas, e kam parkuar para dyerve të A.... Aty kur kemi shkuar e kam gjet T.. dhe aty A.. i shtëpisë, kemi shkuar unë dhe .Z., Kur kam shkuar aty, kam pirë kafe, T. i ka thënë dajës se me këta jam marrë vesh, unë jam ka e pres M., unë i kam thënë dajës, se për çka më prunë këtu, ai më tha, hyri nëpër tema tjera, duke më thënë se ta ka marrë edhe dikush tjetër, unë i thash, se lëri ato tema se janë të vjetra para 50 vjetëve. Me T., e kemi lënë se pasi të merremi vesh ne vëllezërit mu marrë vesh edhe me te. T.. ka thënë se unë e kam blerë këtë tokë, i kam marrë paret borxh, ka dal duke bërëtitur, dhe unë i kam thënë merri paret tuaja nga ai që ia ke dhënë (vëllai). Biseda nuk ka qenë e tensionuar, por kur ka dal T.. e ka ngritë zërin dhe ka thënë se edhe vëllai im më ka thënë se nuk dua me pas punë me P. dhe më ka thënë se paret i kam marrë borxh. Kur kemi dal jashtë jemi ndal tek dyert e oborrit. T.. ka piskat duke thënë se i kam marrë borxh paret, dhe më ka thënë se do të shkojë në polici, unë i kam thënë se e drejta e jote është. Vetura e ime, e dajës dhe e T.. vetura e jeme ka qenë kah dyert, e dajës ka qenë afër kerrit të vet, ndërsa e T. ka qenë 2 metra më larg në drejtim të Gjakovës. Z.. e ka ndezë kerrin dhe ka shkuar. A.. ka tentuar me e ndal T... për me u marr vesh. T.. ka pas mundësi me u largu T.. me kerr të vetin pa u largu unë. A... nuk ka qenë fare në shtëpi. Kur ka ardhur A.. në vendin e ngjarjes unë kam qenë duke hyp në kerr. Dhe nuk ka fol kurgjo. Kur kam dal kam fol me të se kemi pas me shkuar tek dhëndëri, dhe i kam thënë se bohi gati se erdha. I akuzuari ka vazhduar tutje se jemi tre vëllezër dhe prona është e pa ndarë e të treve dhe ky vëllai i tretë nuk ka biseduar me T.. Vëllai M... ka qenë tek unë dhe kemi biseduar për pronën mirëpo nuk jemi marr vesh, po ashtu A. tek livadhi nuk ka qenë dhe i njëjti është djali i dytë dhe e ka ditur që kemi mosmarrëveshje për këtë pronë me T.. dhe koha që sa është kjo saktë nuk e di, unë e kam marrë vesh mbas nja 5-6 muajve. E kom marrë vesh në livadh kur i ka qitë punëtorët me i vendos hunjë të dhe aty e kam kuptuar se e ka shitur vëllai, vëllai më ka thënë se e kam shitur 1000,00 €. Nuk jam larguar menjëherë pasi që daja ma kishte zënë rrugën, e pa u larguar ai unë nuk kam mundur me u largu. E kam telefonuar A.. kur kam dal prej odës, kanë telefon edhe bashkëshortja dhe vajza. Unë e di se vetura e T.. ka qenë në drejtim kah Gjakova, pasi që ai ka hyp e ka dhezë kerrin dhe ka dal prapë prej kerrit. Kur ka ardhur A.. në vendin e ngjarjes kam tentuar me e ndal, duke u munduar me e ndal me duar, por nuk kam mundur, pastaj ka tentuar A., A.. i ka qenë në rrugë, ndërsa T. ka qenë nja 4 metra larg tij, tek kerri. Pasi ndodhi rasti, unë nuk e kam marrë A..., nuk e kam pa më, ai ka shkuar me u dorëzuar, kur ka kërkitë unë jam hup, asnjë send nuk i kam thënë djalit diçka me gojë. Nuk më kujtohet sa herë kam biseduar me A..., por më duket një herë. Z.K., ka qenë T., A...dhe Unë, kanë qenë prezentë kur ka ardhur A... Pas rastit që ka ndodhur, nuk i kam dhënë

ndihmë askujt, pasi kur ka kërshur unë kam humbur. Daja rrugën ia ka qel T..., se nuk kishim mujt me dal as unë e as .T., pa u largua daja. Unë në këtë moment veç kam hyp në kerr, e kam thirr djalin me i thënë bonu gati se donim me shkua tek dhëndri. Djali nuk ka vonuar nja 2-3 minuta ka ardhur pas që e kam telefonuar. Jo nuk u kon Z.. aty kur ka ardhur A... Distanca në mes të shtëpisë time dhe të A.. është nja 500 metra distancë, ndërsa me e përshkruar në këmbë 2-3 minuta. KTGJ ka pyet se ju deklaruat në fillim se kur ka ardhur daja në shtëpi, i keni thënë se jam marrë vesh unë me T..., pse shkove në Odë kur jeni marrë vesh? I akuzuari ka deklaruar se shkova se ai më tha hajde, dhe unë thashë po shkojë veç me ndëgju fjalët. KTGJ ka pyet se ju deklaruat se e keni thirrre A.. në telefoni dhe i keni thënë se bëhuni gati për me shkuar tek dhëndri, meqenëse po thuani kështu qysh ka mundësi që A... të vie me armë tek A..? I akuzuari ka deklaruar se e ka ndi poterenpiskamën e T. dhe për atë arsye ka ardh, pasi që ndihet natën shumë. Arma ka qenë në sallon, ndër fotele dhe e kanë ditur të gjithë se ku gjendet. KTGJ ka pyet se a është e vërtetë se kur u ardh A. .automjeti i T.. ka qenë i ndezur, dera ka qenë e hapur dhe T... ka qenë jashtë veturës? I akuzuari ka deklaruar se po e vërtetë është. KTGJ e ka pyet se a është e vërtetë se ju e keni pasur të hapur derën e automjetit dhe keni qenë jashtë kerrit? I akuzuari ka deklarua se dera e automjetit ka qenë e hapur kur ka ardhur A., ndërsa unë jam mundur me e ndal. KTGJ ka pyet se sipas deklarimit të këtu të dëmtuarit-i cili është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit A.N., i njëjti ka deklaruar se P., nuk ka marr asnjë veprim për ta ndaluar, dhe i ka ndejtur përmbas, çka keni për të thënë për këtë deklaram? I akuzuari ka deklaruar se nuk është e vërtetë. KTGJ pa pyet se pse po mendon ti se A... po e thotë diçka të pavërtetë, a keni ndonjë problem apo si? I akuzuari ka deklaruar se jo nuk kemi asgjë në mes veti. Ka ekzistuar një kanal shumë i vogël aty (vade-uji që lëvizë). KTGJ ka pyet se a ki fol më përpara me vëllain M...se pse e ka shitur pronën? I akuzuari ka deklaruar se po kam fol me te, dhe i kam thënë se ne ende nuk jemi nda, kur të ndahemi shitja kujt të duash. KTGJ ka pyet se në livadh kur keni shkuar dhe jeni takuar me T... dhe jeni njoftuar për tokën, a është e vërtete se T... e ka thirrre M... në telefon për me fol ti me te? I akuzuari ka deklaruar se po është e vërtetë, kam fol me interfon me M... ku më ka thënë se vi nesër e folim.

3.Vlerësimi dhe analizimi i provave

Gjykata, ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe të njëjtat i vlerësoi një nga një dhe në lidhmëni me njëra tjetrën konform nenit 362 par.2 të KPP-së, ka vërtetuar këtë gjendje faktike si vijon:

I akuzuari P.GJ., si kryefamiljar, me tani të ndjerin T.B., kanë pasur problem me pronën të cilën i ndjeri e kishte blerë nga vëllai i tij M., e cila pronë ka qenë në emër të tre vëllezërve Gj.. e cila nuk ishte e ndarë dhe se M.. pjesën e vet ia kishte shitur të ndjerit T...për të cilën gjë i akuzuari P.GJ., nuk ishte pajtuar gjë që një ditë para ditës kritike kur i ndjeri T.. i kishte angazhuar disa punëtorë për të punuar i akuzuari kishte shkuar tek livadhi dhe nuk e kishte lënë që të punoj dhe atë duke i thënë se deri sa të merrem vesh më vëllain dhe nëse i bie hise atëherë edhe ne ta fal nëse donë kurse i ndjeri i kishte thënë se unë e kam blerë dhe ja kam paguar të hollat, mirëpo ishte larguar së bashku me punëtorët nga livadhi. Këto janë fakte që kanë të bëjnë e gjenezën e konfliktit në mes të familjes B.. dhe familjes Gj..., konflikt i cili natën kritike rezultoi me vrasjen e të ndjerit T.B.,

Gjykata ka konstatuar se lidhur me këtë rast është gjykuar dhe dënuar këtu djali i të akuzuarit A.GJ., për shkak te tri veprave penale të vrasjes nga neni 178 të KPRK-së, lëndimi i rënd trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dhe i është shqiptuar dënim me burgim unik në kohëzgjatje prej 22 vite. Gjykata objekt shqyrtimi të kësaj çështje ka pasur në shqyrtim të akuzuarin e dytë P.GJ., për shkak të veprës penale ndihmë

në kryerjen e veprës penale vrasje nga neni 178 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, duke marr për bazë vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës me numër Pml.nr.394/21 të dt.07.12.2021.

Gjykata pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor lidhur me këtë çështje penale, e në bazë të administrimit të gjitha provave si dhe secilës veç e veç, ku në bazë të deklaratave të dëmtuarve në cilësinë e dëshmitarëve, dëshmitarëve të procedurë gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe provave materiale, deklaramit të vet akuzuarit është konstatuar se ditën kritike i akuzuari me dashje eventuale ka kryer veprat penale ndihme në kryerjen e veprës penale të vrasjes për të cilën ngarkohet.

Gjykata ia ka falur besimin të dëmtuarit A.N., i cili është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit i cili ka dëshmuar se ditën kritike më ka thirr T.B., dhe më ka thënë se do të vjen M...(vëllai i të akuzuarit) për të biseduar për pronën dhe nuk ka ardhur, ku T.. e ka thirr dhe i ai i ka thënë se kurrë gjë nuk kam mujt me bo me vëllain P., dhe ka filluar me qajt në telefon, dhe i ka thënë T.. ndalu ta pinim nga një kafe dikund në qytet, dhe M...i ka thënë, se jo-jo, jo dhe ka shkuar në Zvicër, pastaj T.. e ka thirr Z.K., pasi që e ka pasur nipash, ndërsa P.. dajë, dhe i ka thënë në telefon, se a mundesh me shkuar tek P. me e pyet se çka po kërkon, pas gjysmë ore dikund na ka thirr Z.. në telefon, dhe ka thënë se jam duke ardhur me P.. në shtëpi tek unë, dhe unë mendova se po vjen mu marr vesh, kanë hyrë brenda, e kemi pirë nga një kafe, dhe kemi filluar bisedën rreth asaj prone, dhe Z.K., fillojë me biseduar me nipin e vet, i tha diçka që nuk i pëlqej këtij (P..) dhe u qun mu rreh në sobë teme dhe i ndava, T.. u prek dhe fillojë me dal, ku doli përjashta, unë u mundova me e ndal T.. për me biseduar edhe njëherë për mu pajtuar, kemi dal përjashta T... ka dal i pari, unë kam dal mbas T..., atëherë ka dal P.. dhe Z..., ky e ka nxjerrë telefonin dhe e ka thirrë djalin (A..) në atë tollovi nuk kemi mujt me e përcjell se çka është ka bisedon, veç e di se i ka thënë, hajde se jam tek A..M..., (pasi që baba im e ka emrin M..), dhe jemi dal jashtë dyerve të oborrit, nga dyert e oborrit i pari ka dal T.. mandej kemi dal rend që të gjithë, T. ka shkuar tek kerri i vet, e ka pasur me fytyrë kah D.. dhe kerri i P.. ka qenë me fytyrë (pjesa e përparme) kah D..., kanë qenë si rend ndërsa Z. e ka pas më andej rrugës, mbi dyert e oborrit, dhe P... ka ndejtë në telefon tek dera e kerrit nën stop dhe dera e kerrit ka qenë e hapur, ka qenë rrugë e ngushtë as 3 metra nuk ka qenë rruga, ka qenë e shtruar me zhavorr që e kam shtruar unë me traktor, nuk ka qenë e asfaltuar, dhe në anën e epërme të rrugës ka qenë një vij e ujit e gjerë 70 cm dhe e thellë 70 cm. P.. ka vazhduar që qëndrojë tek automjeti i tij me derë të çelur vetura ka qenë e ndalur, T. nuk ka mundur me kaluar veç me e kap kerrin në shpin, pasi që rruga e ngushtë, dera e hapur, nuk ka mundur. P. ka bërë thirrje vazhdimisht në telefon, mirëpo prej dyerve të oborrit kur ka ardhur kanë qenë në pyetje 3-4 minuta, kur ka ardhur djali i tij A..., i cili ka ardhur në këmbë me vrap dhe ne dorë ka pasur armën kallash, P... e ka parë dhe i ka dal përpara dhe ka shkuar tek vetura e T... me të dhe ai ka filluar me gjuajt. Fillojë me gjujtë dhe unë shkova me i dal në ndihmë për me biseduar me të, dhe ai mu kthy në mua dhe më gjuajti mua në këmbë 4-5 fishekë, ku më ka kapur në këmbë pasi që tyta ishte e ulur, dhe më ka goditur me kondak të pushkës në ballë, dhe jam rrëzuar dhe T.. ka dal prej veturës, ka filluar me ik nga D., dhe thuaj 3 metra është rrëzuar dhe A. ka filluar me e gjuajt apët pasi ka dal prej kerrit, dhe janë kthyer dhe kanë hyp në kerr dhe kanë shkuar, nuk e di ku, ndërsa P., asgjë nuk ka bërë, vetëm e ka përcjellë A... dhe T.. ka qenë tek dera e mbrapa e kerrit të T..., A. ka qenë tek dera e parë kur ka gjuajtur me armë dhe P.. nuk ka marr veprime për me e ndaluar A.. ndërsa kur ka ardhur A.. nuk kanë biseduar me P. asgjë dhe A.. ka shkuar direkt te kerri dhe ka filluar me gjuajt. Kur ka ardhur A. automjeti i T. ka qenë i kthyer për Gjakovë pra nuk ka qenë më i kthyer me fytyrë nga D.. por ka qenë i kthyer përpara nga rruga për me shkuar në Gjakovë, pasi që kur ka dal prej dyerve të oborrit menjëherë e ka kthyer automjetin, dhe automjeti i T.. ka qenë i ndezur dhe dritat i ka pasur të ndezura, por nuk ka pas kah me dal. Rruga nuk ka qenë e asfaltuar pasi që ka qenë me zhavorr, ku tash kjo rrugë është 4 metra, pasi që është shtruar nga Komuna, atëherë ka qenë 3 metra a ka qenë a nuk ka qenë aq dhe ka qenë e shtruar me zhavorr, dhe ka qenë vija dhe kjo vi ka

qenë në anën e majtë të fotografisë. T... ka kërkuar, 2 herë Z.. dhe P.që të ia lëshojnë rrugën, ai ka hy në kerr dhe në ato momente ka ardhur A.. P... a e ka pasur derën e hapur të automjetit dhe ka qenë te automjeti dhe nuk e ka lëvizë automjetin, pas ngjarjes nuk e di se kush ka vozitur, pasi që kam qenë i plagosur, por e di që të dy kanë hyp në automjet, prandaj Gjykata deklaramit të tillë ja fali besimin pasi që ka lidhshmëri me provat materiale dhe me deklaramin e dëshmitarëve te tjerë.

Gjykata ia ka falur besimin të dëmtuarit V.B., (vëllai i të ndjerit), i cili është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit i cili ka dëshmuar se unë kam qenë në Zvicër ditën kritike, por ka dëshmuar se e kemi blerë fillimisht një tokë nga A.. dhe pastaj me ofertën e M.. e kemi blerë edhe një tokë dhe vëllai i kishte thënë M.. se merri vesh ju vëllezërit lidhur me këtë tokë qe po donë me ma shit, ndërsa M. i ka thënë, se nuk kam se çka mu marrë vesh me askënd, pasi që është pjesë e imja, dhe vëllai prapë i thotë bisedo edhe një herë mirë se jemi kojshi dhe mos më qit telashe, M.. i thotë se kurrfarë telashe, ti nuk ki punë me askënd, aty kanë qenë në pyetje 16 ari, ditën e diele të ardhshme është bërë pagesa dhe janë marrë vesh për tokën, mbasi është blerë toka pas 2 viteve, vëllai tha se po du me shku në Kosovë nja 2 ditë në ..., dhe të dielën më tha se po këqyri me i hjek këto mexhe, me e rregulluar pasi që i kemi kryer pagesën, unë i thash mos hyn vet, merri nja 5 punëtor dhe i kryen shpejt e shpejt, ku njëri prej punëtorëve ka qenë K.H., ndërsa të tjerët nuk i kam njohur, kur kanë hy punëtorët me punuar në tokë P.. ka shkuar me dy djemtë me armë me vete dhe e kanë ndaluar punën, dhe i ka thënë se mos punoni, se toka nuk është e jotja, vëllai iu thotë se unë e kam paguar tokën dhe merru vesh me M.. dhe vëllai nuk ka pas qef telashe, i ka hek punëtor, dhe aty për aty e ka thirr M.. dhe M.. i ka thënë se vi nesër në orën 15:00/h dhe takohemi tek A. M...në orën 15:00/h e kam thirr unë, ishte A. duke e pritur M..., ku rreth orës 17:00/h e kam thirr por nuk e hapte telefonin, më ka thirr L.B., dhe me thotë se kanë plagosur bacën T., kur pas disa minutave tjera e kam thirr në telefon por më njoftuan se ka vdekur. Rasti me punëtorët se janë penguar nga P.. dhe djemtë e tij ka ndodhur një ditë para vrasjes së vëllait. M.. ka ardhur ditën kur ka ndodhur vrasja në Kosovë, ku pastaj kanë biseduar në telefon dhe ka thënë le këtë punë se bisedojmë më vonë se është situata e keqe, prandaj Gjykata deklaramit të tillë ja fali besimin pasi që ka lidhshmëri me provat materiale dhe me deklaramin e dëshmitarëve te tjerë si dhe këtë nuk e mohon edhe vet i akuzuari përveç faktit se nuk ka qenë edhe djali i tij A...dhe se kanë qenë të armatosur.

Gjykata ia ka falur besimin dëshmitares SH.N., e cila ka dëshmuar se ditën kritike, kam qenë në shtëpi ku ka ardhur T.. ka ardhur tek ne ka pas me u marrë vesh me vëllain e këtu të akuzuarit M..., por ai nuk ka ardhur, ka ardhur i akuzuari dhe i kam dëgjuar duke u përllarë me fjalë pasi që ne ishim në një dhomë tjetër dhe i kemi dëgjuar. Në odë të burrave përveç T.. dhe të pandehurit P. ka qenë edhe Z.K., dhe biseda në odë ka qenë nja 20 minuta. Nuk i kam ndi se çka saktë kanë biseduar por i kam dëgjuar duke u përllarë, duke bërëtitur. Aty ka dal T. dhe ka shkuar tek dyert e oborrit dhe i ka thënë se nuk kam punë me ju duke iu drejtuar të akuzuarit, ku i ka thënë se do ta rregullojmë me polici dhe me gjykatë, ku i ka thënë kthemi paret e mia dhe merre tokën pasi që nuk kam punë me ty. T.. ka dal i pari, pastaj i akuzuari i dyti dhe Z.K., i treti. Pasi dolën jashtë, T.. dojke me shkuar por i akuzuari nuk ia lëshojke rrugën ia ka zënë kerrin. T... e ka pasur kryet e kerrit të kthyer nga D., pastaj hypi në kerr e kthejë dhe thojke lëshoma rrugën të akuzuarit P.. Gj., pasi që i akuzuari e kishte kerrin në rrugë. I akuzuari rrinte në telefon duke folur, ku nuk ka vonuar shumë e ka ardhur djali i tij me automat, ndërsa ky e linte derën e kerrit të çelur dhe rrinte te kerri. Nuk e kam dëgjuar por dihet se me kënd ka folur me djalin e vet, pasi që dy tri herë ka folur. Prej momentit kur kanë dal prej odës e deri te dera, e deri sa ka ardhur A., ndoshta ka zgjat 5 minuta përafërsisht, s'po di. Kur A... erdhi, P. ka qenë tek kerri i vet, ky (A..) ka ra përskaj të tij duke shajtur T.. dhe pastaj i ka mëshuar automat dhe nuk ka tentua mi ndal hiq. T.. kur e ka kthyer automjetin nuk ka pasur shanse me dal me automjet pasi që ka qenë lloqë (balt), e nuk ka qenë qysh është sot e asfaltuar, pasi që ka qenë një vijë e ujit, e me pas tentuar me dal kishte ra në vijë të ujit. P... ka pasur derën e automjetit të hapur gjatë gjithë kohës. Kur e kam ndi P.. tu fol në telefon ka ardhur A.. për 5-6

minuta më tepër nuk ka pas, shtëpia e P.. prej shtëpisë sonë është 5 minuta. P. në këtë situatë nuk ka bërë asgjë, vetëm i rrike mbas, prandaj Gjykata deklaronit të tillë ja fali besimin pasi që ka lidhshmëri me provat materiale dhe me deklarin e dëshmitarëve te tjerë të cilëve Gjykata ia ka falur besimin.

Gjykata ia ka falur besimin dëshmitarit Z.N., i cili ka dëshmuar se ditën kritike kam qenë në stallën time të lopëve dhe kam dëgjuar krismat, ku prej stallës deri tek vendi i ngjarjes sa është dikund nja 30 metra, ndërsa kam dëgjuar vetëm krisma, kur kam dal e kam gjetur vëllain A..të plagosur, dhe i kam thënë se çka u bë, ai më tha se A.Gj., më ka lënduar, prezentë aty ishte Sh..dhe V., nja 5-6 metra larg vëllait ka qenë T... i shtrirë, pasi që vëllai më tha lërmë mua se T.. është keq. Kerri i T... ka qenë i ndezur, në drejtim të Gjakovës dhe dera e shoferit ka qenë e çelur. Unë e kam dërguar T... dhe A.. në spital me një automjet, nuk kam parë askënd duke u larguar apo ndonjë automjet duke u larguar vetëm siç e shpjegova më lartë, edhe pse nuk ka qenë dëshmitar okular kur ka ndodhur rasti i njëjti dëshmon se më të shkuar në vendin e ngjarjes aty kanë qenë prezent dëshmitarët Sh., dhe V., pra dëshmon se kanë qenë në vendin e ngjarjes, po ashtu me deklarin e tij vërtetohet dëshmia e dëshmitares Sh., dhe V., pasi që i njëjti ka deklaruar se kerri i T...ka qenë i ndezur dhe derën e ka pasur të hapur për çka ka lidhshmëri me deklarimet e dëshmitarë të potencuar më lartë.

Gjykata nuk ia fali pjesërisht besimin deklaratës së dëshmitares J.GJ., e cila ka dëshmuar se ditën koritke ka qenë në shtëpi po ashtu në shtëpi ka qenë edhe P. dhe A., pastaj ka ardhur Z.K., pasi që i tha burrit hajde me shkuar për me u marrë vesh tek A.,, mu marrë vesh me A., dhe T..., burri i tha, se unë me T.. jam marrë vesh, veç po vi po i ngoje fjalë, kur ka ndodhur rasti unë kam qenë në oborr, duke vaditur lulet, kam dëgjuar piskamë dhe bërtim. Veç zëra janë ndi, zërat kanë ardhur prej së poshtmi, kam hy brenda dhe i kam thënë djalit se kam dëgjuar një piskam prej së poshtmi, e daja Z...e ka marrë babën e kanë shkuar tek A.. Nuk kam ndi por telefonin djali e ka pasur në dorë. Është quar si i habitur, ka marrë armën dhe ka dal përjashta, unë i thashë, e ku po shkon djali i jam, pa thënë asgjë, ka dal si i huptë. Pastaj, çika më tha se krisi diçka poshtë, pastaj ka ardhur burri dhe tha mozamakeq sa çka u bo, pastaj kanë ardhur policia dhe u mbush soba dhe nuk më ka ra me biseduar më gjatë me te. A.. a ka qenë në gjumë. Është e vërtetë se në procesverbalin e datës 14.10.2020 të dhënë në gjykatë, kam deklaruar se keni pasur në plan për të shkuar tek motra e P...Kur kam hy unë në dhomë, A.. u qu dhe unë i thashë se daja Z. e ka marrë babën dhe kanë shkuar tek A.,

dhe po ndihet një bërtitmë dhe ai e ka marrë armën dhe ka dal si i hutuar. Shtëpia e jonë prej shtëpisë së A., distancën nuk e di saktë por një kodër e kemi në mes. Deklarimi i kësaj dëshmitare është kontradiktor pasi që nga i akuzuari P. i njëjti ka deklaruar se A.. ka qenë në qytet e jo në shpi apo në gjumë siç deklaroi dëshmitarja, po ashtu sipas deklarimeve të dëshmitarëve biseda jashtë dyerve të oborrit ka qenë e qetë dhe pa bërtima këtë e ka dëshmuar Z.K., dhe A.N., dhe nuk qëndron fakti se prej shtëpisë së të njëjtës ku ka një kodër në mes dhe distance në këmbë prej 4-5 minuta të jetë dëgjuar biseda nga oborri i dëshmitares, po ashtu e njëjta ka deklaruar se A.. e ka pasur telefonin në dorë çka do të thotë këtë e konfirmon edhe i akuzuari P.. dhe prova materiale listingu i thirrjeve se këta të dy kanë komunikuar nëpërmes telefonit, andaj deklarata e kësaj dëshmitare nuk ka lidhshmëri me provat materiale dhe deklarin e dëshmitarëve tjerë, për çka gjykata nuk ia fali besimin.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarit T.G., i cili ka deklaruar se me të pandehurin P., njihemi pasi që kemi kumari dhe ndiqemi familjarisht dhe kemi raporte të mira, për çështjen e pronës me mua personalisht jo nuk ka biseduar, veç e di se e kanë pasur një mosmarrëveshje. Ditën kritike më ka thirr A... dhe e kam dorëzuar në polici dhe tek shtëpia kemi biseduar në telefon me policin dhe pasi që është përshëndetur me familjen P. ka qenë në shtëpi. Në fsh.... kur e kam takuar A.. ka qenë në këmbë, dhe më ka thënë se kam ardhur në këmbë, e ka pas armë të gjatë garant ka

qenë kallash. Deklarimi i tij nuk ka qenë relevant për këtë çështje pasi që i njëjti nuk ka qenë dëshmitar okular.

Gjykata ia ka falur besimin dëshmitares V.N., e cila ka dëshmuar se ditën kritike kam qenë në shpi ka ardhur T...pastaj Z.K., dhe P.GJ., ata kanë qëndruar në odë, ndërsa ne kemi qëndruar në një dhomë tjetër me gruan e babës dhe me djalin e motrës dhe unë kam hyrë në odë vetëm kur i kam shërbyer me kafe. Ajo ka theksuar se kam dëgjuar bisedën në mes të T...duke thënë se “unë u mundova me e zgjedhë me të mirë por meqenëse ju nuk po doni tash kam me e zgjedh me polici dhe me gjyq”. Nga oda së pari ka dal T...pastaj ka dal P., Z.. si dhe baba im Anton N.. T. ka hyp në veturë dhe e ka kthye veturën për me shkuar dhe P... dhe Z... i kanë pasur kerret në rrugë dhe T.. nuk ka pasur kah me dal ngase rruga u kanë e pa ndreqën dhe ka qenë shumë lloç dhe T.. e ka ndez veturën, e ka lanë ndezë dhe iu ka thënë këtyre lëshomani rrugën të shkoj. P.. e ka qel derën e veturës së tij dhe i njëjti nuk ka hyrë asnjëherë në veturë por ka ndjetë jashtë, u sillte rreth veturës dhe ka fol me dikën në telefon dhe i ka thënë “jam tek shpija e A.M.”. Kam qëndruar aty mundem edhe 4 minuta dhe pastaj e kam marr djalin e motrës dhe kam hyrë brenda. Nuk ka kaluar as 1 minutë prej kur kam hy brenda, atëherë i kam dëgjuar krismat. Kur kam dal jashtë përveç A., dhe T..., nuk kam parë askënd pra nuk ka pas persona tjerë, nuk i kam parë P... dhe A..., por e kam parë babën që ka qenë i ulur në tokë dhe e kam parë që ka pas gjak në fytyrë dhe në këmbë dhe kur jam ofruar afër më ka thënë “lemë mu se jam mirë por shko tek T..”. Vetura e T.. ka qenë e ndezur dhe kur kam dal e kam parë që dera e veturës së T.. ka qenë qelë pra dera e shoferit. T...ka qenë larg automjetit të tij rreth 3-4 metra. Kur T.. e ka kthyer veturën për në drejtim të Gjakovës e kam parë personalisht dhe se T.. nuk ka mund me dalë për shkak se veturat kanë qenë në rrugë dhe pjesa tjetër ka qenë shumë lloç dhe nuk ka mund me kaluar, prandaj Gjykata deklaramit të tillë ja fali besimin pasi që ka lidhshmëri me provat materiale dhe me deklaramin e dëshmitarëve te tjerë të cilëve Gjykata ia ka falur besimin.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarit L.B., i cili ka deklaruar se ditën kritike duke u kthyer për shtëpi e kam parë veturën e bacës T.. tek dyert e A... dhe kam shkuar aty kam zbritë prej veture dhe ora saktë nuk më kujtohet por ka qenë duke u terruar pra pak para vrasjes. Pasi që kam zbritë prej veture, ka ardhur baca T... dhe Z.K., dhe më ka thënë hyp në veturë se e kemi rregulluar punën dhe duke hyp në veturë e kam dëgjuar P.Gj., duke i thënë dikujt “hajde” dhe se me kënd ka qenë duke fole nuk e di. Kam vazhduar për në shtëpi, sapo kam hyrë në oborr pasi që kam dalë nga vetura e kam dëgjuar krismën dhe menjëherë kam shkuar në vendin e ngjarjes por aty ka pas shumë njerëz. Ai ka shtuar se në momentin kur kam shkuar për herë të parë në vendin e ngjarjes nuk kam dëgjuar ndonjë zhurmë apo ndonjë tension në mes të personave që kanë qenë prezent çdo gjë e qetë. Deklarimi i tij nuk ka qenë relevant për këtë çështje pasi që i njëjti nuk ka qenë dëshmitar okular, kur ka ndodhur rasti.

Gjykata ia ka falur besimin dëshmitarit Z.K., (tani i ndjerë), i cili kishte dëshmuar se ditën kritike kam qenë në fshatin M..., pikërisht në shtëpinë e P.GJ., dhe se kam shkuar me kërkesën e T.B. i cili ka më ka kërkuar që të shkoj tek P.Gj., që ti them “çka kërkon ti prej meje se unë parët i kam la”. Duke shkuar tek shpija e P., T.B., më ka thirr në telefon tek dera e shtëpisë dhe më ka thënë “thuaj P.. se nëse donë hajde tek Anton N.. që të merremi vesh”. Tek shtëpia e P.. kam shkuar rreth orës 15:00/h dhe aty në dhomën ku rrinë kanë qenë vetëm P. dhe bashkëshortja e tij. A..i nuk ka qenë prezent. P. më tha se i ka fajet vëllai jem M.. që e ka shit tokën pa më pyetur mua. Nga shtëpia e P. jemi nisë për në shpinë e A., P.. ka shkuar para meje dhe unë pas tij. Ne aty nuk u morëm vesh për shkak se P.. thojke se “i ka fajet vëllai jem M.. që ia ka shitë pa e vetë hiq”, pasi që edhe P. kishte pas hise në atë tokë. Meqenëse nuk u morëm vesh T.. tha se këtë punë e lajmë për gjykatë. Kur kemi dal nga oda kemi dal gati si grumbull, meqenëse T.. tha se këtë punë e lëmë për gjykatë, jashtë dyerve është fole A.. ka kërkuar edhe një herë me hyr e me u marr vesh dhe daja T., thojke

jo se e lajmë për gjykatë dhe kur ai tha kështu unë veç kam hyp në veturë, e kam ndez dhe kam ec, ai ka shtuar se para se të nisem për në Gjakovë, vetura e T.. ka qenë me krye kah Gjakova, veturat kanë qenë shumë afër dhe se ka qenë shumë lloç dhe se nuk kemi mund me lëviz. T.. pa e larguar P.. veturën nuk ka mund me ecë ngase ka qenë bukur zor për shkak se ka qenë lloç. Ai ka shtuar se kur jam larguar me kerr aty i kam lënë këta të tretë T., A.. dhe P.... Situata nuk ka qenë e tensionuar ngase të po të kishte qenë situata e tensionuar unë nuk isha larguar. Ai ka shtuar se kam hyrë në veturë dhe jam nisë për në Gjakovë, ngase T.. thojke veç për gjykatë pastaj eca me veturë dhe skam ecë as 20-30 metra prej vendit të ngjarjes veç kur e kam dëgjuar krismën e armës dhe në pasqyre të veturës e kam parë edhe flakën e armës, krismat kanë qenë “ding, ding” i kam gra veturës deri tek shpija e V.t- vëllait të A. N.. E kam parku veturën para dyerve të shtëpisë së tij, kam dalë dhe kam shkuar atje dhe i kam parë të shtritë A., dhe T.B., kanë qenë edhe familjarë të N., deklarata e këtij dëshmitari dëshmon se nuk kanë mundur të merren vesh, po ashtu faktin se i akuzuari P. ka ngelur në vendin e ngjarjes pas largimit të tij edhe për kundër faktit se ky ka qenë në rrolin e ndërmjetësuesit për ti pajtuar.

Gjykata ka vlerësuar vetëm provat materiale që lidhen më të akuzuarin e dytë P.Gj., dhe nga këto prova si nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes të oficerit SH.Z., me numër të rastit 2019-EA-243 i datës 12.03.2019, së bashku me tabelën e matjeve dhe skicën e pa shkallëzuar, ku kishin shkuar në vendin e ngjarjes në fshatin ku shihet kishin bërë fotografimin e vendit të ngjarjes dhe shihen gjurmët të gjetura, të cilat janë evidentuar dëshmia nga nr.4 deri nr.19. Të njëjtit kanë bërë edhe matjet fikse të gjurmëve të gjetura në vendin e ngjarjes të cilat kanë evidentuar në tabelë të matjeve dhe të njëjtat janë vendosur edhe në skicë. Nga listingu i hyrjeve-daljeve nga listat e PTK-së, për numrat e telefonave dhe atë: 045-215-641 të cilin e shfrytëzonte i akuzuari A.GJ., dhe të cilin e shfrytëzonte i akuzuari P.GJ., gjykata ka vërtetuar faktin se të akuzuarit përmes numrave të telefonit të lartë cekur gjatë ditës me datën 12.03.2019 nga ora 09:59 minuta deri në kohën kur janë kryer veprat penale në ora 18:35 minuta kishin pasur kontakt telefonik pesëmbëdhjetë (15) herë. Ashtu që nga këto thirrje natën kritike, 5 minuta para se të ndodhë rasti, kishin komunikuar përmes telefonit tre (3) herë dhe atë: 18:24, 18:25, 18:35 minuta. Po ashtu nga raporti i Njësisë Forenzike të Stacionit Policor në Gjakovë - mbi rikonstruimin e vendit të ngjarjes të bërë me datën 02.10.2020, i dorëzuar gjykatës me datën 12.10.2020, së bashku me foto albumin nga fotografia 1 deri në 40 në 21 faqe, gjykata për të vërtetuar në mënyrë sa ma të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, si dhe për të pasur një vlerësim sa ma real të provave, ku kishte dal në vendin e ngjarjes Gjykata me palët në procedurë si dhe me zyrtarët policor nga Njësi i Forenzikës, me datën 02.10.2020, kanë dal dhe kanë bërë rikonstruimin e vendit të ngjarjes në fshatin ... Komuna e Gjakovës përkatësisht para dyerve të shtëpisë së të dëmtuarit A.N., Zyrtarët policor të Njësisë së Forenzikës, fillimisht kishin vendosur shenjat përkatësisht pikat e gjurmëve që janë gjetur natën kritike me datën 12.03.2019, të njëjtit kanë bërë fotografimin e vendit të ngjarjes si dhe matjen e disa pikave të caktuara në vendin e ngjarjes, që janë konstatuar në procesverbalin mbi rikonstruimin e vendit të ngjarjes të datës 02.10.2020 dhe në raportin e lartshënuar.

Gjykata në bazë të prova të lartcekur dhe dëshmi të dëshmitarëve të cilëve iu ka falur besimin ka vërtetuar se i akuzuari P.GJ., e ka ndihmuar të birin e tij A... (tani i dënuar) që të kryej veprën penale të vrasjes, fillimisht motivi ka qenë i pa kontestuar për faktin e pronës të cilën vëllai i tij ia kishte shitur të ndjerit gjë për të cilën nuk ishte pajtuar i akuzuari P.GJ., dhe për këtë ishin mundur të merren vesh duke ndërmjetësuar në oden e A.N., ku kishte tentuar edhe daja e të akuzuarit Z.K., mirëpo nuk kishin arritur dhe i ndjeri pasi që nuk ishin marr vesh kishte deklaruar se le të merren me këtë punë polica e gjykata.

Gjykata ka konstatuar veprimet e të akuzuarit P.Gj., në dhënin e ndihmës që kanë të bëjnë para kryerjes së veprës penale të vrasjes nga djali i tij A...fillimisht djali i tij ka ditur lidhur me

problemin pronësor që e kanë me T.B., dhe vëllain e të akuzuarit – M...po ashtu janë dhënë mjetet e kryerjes së veprës penale në dispozicioni kjo vërtetohet nga vet deklarimi i të akuzuarit P.Gj., pasi që i njëjti ka deklaruar se arma AK-47 me të cilën është kryer vepra penale, ka qenë e babit tim dhe këtë e kam lënë nën fotele në sallon duke vepruar kështu qasja e familjarëve ka qenë shumë e lehtë tek arma me të cilën është kryer vepra penale. Po ashtu sipas deklarimit të dëshmitarëve pas daljes nga oda e A.N., pasi që nuk ishin marr vesh dhe i ndjeri ju kishte drejtuar me fjalët se “për këtë punë do të ju lajmërojë në Polici dhe Gjykatë”, tek dyert e oborrit është vërtetuar se P., e ka parkuar veturën e tij të markës “WV- ..”, me tabela të regjistrimit ..., pas automjetit të ndjerit T.B., të markës “Sander” me tabela të regjistrimit, që ishte në drejtim të D..., në cilin drejtim nuk kishte dalje, kjo ka mundur të jetë rastësi, por në momentin kur i ndjeri kishte hyrë në veturë e kishte nderur dhe e kishte kthyer veturën në drejtim të qytetit duke kërkuar nga i akuzuari dhe dëshmitari Z.K., që të ia lirojnë rrugën dhe momentin kur Z.K., largohet, i akuzuari P.GJ., e hap derën e veturës duke mos i lëshuar rrugën të ndjerit i cili prapë kishte kërkuar që të ia lëshoj rrugën pasi pjesa tjetër e rrugës ishte me baltë dhe po ashtu ishte një kanal i hapur dhe nuk kishte mundësi të lëvizte veturën e tij, i akuzuari me qëllim që ta pengonte lëvizjen e të ndjerit, nuk e largonte veturën e tij të cilës ia kishte hapur derën e shoferit, kjo konsiderohet ndihmë para kryerjes ... e kishte thirr të akuzuarin A...duke e njoftuar dhe duke i thënë “se jam tek shpija e A.M.”, ku i akuzuari A., e kishte marr pushkën automatike dhe kur arrin tek vendi i ngjarjes fillimisht gjuan në drejtim të automjetit tani të ndjerit, i cili pasi del nga automjeti për tu larguar gjuan sërish në drejtim të tij duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse, ashtu që pas kryerjes të vrasjes me automjetin e tij i akuzuari P. së bashku me të akuzuarin A... largohen nga vendi i ngjarjes. Pra Gjykata fillimisht ka vërtetuar faktin se i akuzuari P.Gj., ndihmën e ka dhënë me dashje eventuale pasi që sipas dëshmisë së dëshmitarëve i njëjti as që ka tentuar që ta ndaloj të birin e tij A.... që të kryej veprën penale dhe se tërë kohën i ka qëndruar prapa dhe nuk e ka ndaluar as me fjalë apo me veprime, por i ka shkuar prapa dhe me rastin e ekzekutimit tek makina e të ndjerit A... ka qene tek dera e pare ndërsa P. tek dera prapa pra duke i qëndruar prapa, (kjo konsiderohet ndihme gjate kryerjes së veprës penale) pra me vet faktin se kur ka ardhë A.. me arme dhe nuk ka biseduar fare por menjëherë ka vepruar kjo kupton se situatën e ka kuptuar pas bisedën me te akuzuarin P. i cili e kishte telefonuar dhe e kishte njoftuar për ngjarjen, po ashtu faktin tjetër se i njëjti i ka dhënë ndihme duke e telefonuar në telefon duke ia treguar vendndodhjen e tij dhe të viktimës (ndihmë para kryerjes së veprës penale), ku i biri i tij vjen më vrap dhe pa biseduar asnjë fjalë shtinë në drejtim të viktimës. Pra të gjitha këto veprime të kryera nga i akuzuari P. janë veprime të cilat objektivisht e kanë ndihmuar të dënuarin A.. që të kryej veprën penale të vrasjes, pra në mes të kryerësit A.. dhe ndihmësit P. ka ekzistuar raporti apo lidhja e caktuar, pasi që P.. e ka ditur se cilit person është duke i ndihmuar pra djalit të tij i cili ka qenë i njoftuar me problemin pronësor dhe e ka telefonuar me telefon dhe e dinte se është duke ardhur tek vendi i ngjarjes, pra me vet faktin se i ka krijuar pengese viktimës që mos të largohet, po ashtu me thirrjen e telefon te kryerësit, pastaj largimi i të dyve me veturë pas kryerjes së veprës penale kjo konsiderohet ndihme me veprim, ndërsa me vet faktin e mos ndalimit te djalit të tij dhe qëndrimit pas tij gjatë kryerjes së veprës penale kemi ndihme me mos veprim.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit P.GJ., avokatit S.M., ku sipas mbrojtjes nuk është vërtetuar dashja, duke i krijuar kushte për ti ndihmuar në kryerjen e veprës penale. Sipas vlerësimit të gjykatës ky pretendim është i pa bazuar, ngase fillimisht dashja eventuale e të akuzuarit vërtetohet nga thirrjet që ia kishte bërë të akuzuarit A... menjëherë pas daljes nga oda, pesë (5) minuta para se të ndodhë rasti, kishin komunikuar përmes telefonit tre (3) herë dhe atë: 18:24, 18:25, 18:35 minuta, ku dëshmitarët A..., Sh... dhe V.N., e kishin dëgjuar të akuzuarin duke i thënë “se jam tek shpija e A.M.”. Po ashtu dëshmitari-i dëmtuari A.N., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: “A.. nuk ka biseduar me P., unë kam qenë rreth 3-4 metra përafërsisht larg veturës së T...ashtu që A.. si ka ardhur fillimisht ka shkuar tek dera e veturës së

T... ka gjuajtur me automatik, pra me mos veprimin e të akuzuarit P.. është krijuar dashja eventuale pra e ka dashur që pasoja të shkaktohet. Në ato momente P... ka shkuar bashkë me A..., tek vetura e T. dhe A. ka qenë tek dera e parë ndërsa P.. ka qenë tek dera e mbrapa e veturës”. Po ashtu gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari e ka njoftuar se nuk ka marrëveshje nëpërmjet telefonit e jo sipas dëshmisë së dëshmitares J.GJ., se janë dëgjuar bërtima, pasi që nuk ka mundur të dëgjohej për shkak të kodrës dhe distancës shtuar këtu edhe pretendimet e mbrojtjes se bisedat kanë qenë të qeta, pra me vet ardhjen e djalit të akuzuarit me armë AK-47 jep me kuptuar se i akuzuari e ka njoftuar nëpërmjet telefonit, pastaj me krijim e kushteve e cila është sqaruar në pasusin paraprak, lidhur me largimin e veturës e dëshmojnë dëshmitarët e lartcekur se i ndjeri kishte kërkuar nga P. që të ia lëshoj rrugën, mirëpo i njëjti duke ditur se ishte duke ardhur A...nuk vepron madje edhe duke e hapur derën e veturës së tij duke mos ia mundur që të largohet, po ashtu edhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit Gjykata ka konstatuar se ka deklarime kundërthënëse ku i njëjti ka deklaruar se “kam biseduar me telefon me A.. pasi që kemi pasur që të shkojmë tek motra, dhe i kam thënë bëhuni gati” ndërsa si rrjedhi që A.. të vie me armë AK-47 dhe pa biseduar me askënd ka vepruar duke e privuar nga jeta të ndjerin, atëherë vie në pyetje fillimisht se si erdhi A.. me armë tek vendi i ngjarjes, si u informua se nuk kishte marrëveshje si rrjedhi pra pa biseduar me askënd ta privoj nga jeta të ndjerin, e që sipas logjikës i njëjti është njoftuar nga P.. nëpërmjet të telefonit. Prandaj sipas gjykatës është vërtetuar raporti apo lidhja subjektive midis ndihmësit dhe kryesit të veprës penale. Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se i akuzuari nuk i kishte krijuar kushte dhe se nuk e kishte penguar të ndjerin T.. që të lëvizte ngase kishte hapësirë mjaftueshme, sipas vlerësimit gjykatës ky pretendim është i pabazuar, ngase është në kundërshtim me dëshminë e dëshmitares SH.N., e cila ka deklaruar se “prej vendit ku ka qenë vetura e P. dhe vetura e T...dhe nëse kishte qenë edhe vetura e P. aty, nuk ka mundur me u larguar me veturë T.., ngase ka qenë lloç dhe ka qenë një vij që tash e kanë rregulluar dhe e kanë bërë asfalt, e kam dëgjuar T... duke thënë P... lëshoma rrugën”. Po ashtu këtë e ka vërtetuar edhe A.N., i cili ka dëshmuar se nuk ka mundur me kalua veç me e marr kerrin në krah, andaj Gjykata dëshmisë së dëshmitares Sh. dhe A. N... dhe të tjerëve të elaboruara si më lartë, ia ka falur besimin e plotë, ngase deklaramet e tyre janë përputhur në tërësi edhe me konstatimet që janë bërë gjatë rikonstrimit të vendit të ngjarjes ngase dëshmitarja Sh..e kishte përshkruar vijën përkatësisht kanalën që është evidentuar me shenjën nr.43 gjatë rikonstrimit të vendit të ngjarjes, e po ashtu deklarimi i saj ka qenë në përputhje edhe me fotot që ishin bërë natën kritike ku shihet balta në rrugë. E po ashtu edhe dëshmitari A.N., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk ka mundur me kaluar veç me e marr kerrin në krah pasi që pjesa tjetër ka qenë me lloç (baltë) pra ka pasur pengesë për largimin e automjetit”, mirëpo i njëjti gjatë rikonstrimit të vendit të ngjarjes pas konstatimit se kanali ekzistonte vërtetë ai ka deklaruar se “T.. nuk ka pasur mundësi të kaloj për shkak të tij”. Po ashtu edhe dëshmitarja V.N., ka deklaruar se “T.. nuk ka mundur me dalë për shkak se veturat kanë qenë në rrugë dhe pjesa tjetër ka qenë shumë lloç dhe nuk ka mundur me kaluar”. Gjithashtu edhe dëshmitari Z.. K.. ka deklaruar se: “T. pa e larguar P.. veturën nuk ka mundur me ecë ngase ka qenë bukur zor për shkak se ka qenë lloç”. Prandaj sipas vlerësimit gjykatës duke marr për bazë faktin se i ndjeri e kishte kthyer veturën, e kishte të ndezur makinën dhe dritat, kishte kërkuar nga i akuzuari P..që ti liron rrugën. Po ashtu duke marr për bazë faktin se në kohën kur kishte ndodhur ngjarje rruga kishte qenë me shumë baltë edhe po ashtu ishte edhe kanali, nga këto vërtetohet se i ndjeri kishte pengesa për të lëvizur me automjetin e tij, pa e larguar veturën e akuzuarit P... Fakti se i akuzuari P. i kishte krijuar kushte të akuzuarit A. për kryerjen e veprës penale është pikërisht mos largimi me qëllim të veturës së tij ngase i njëjti ishte në dijeni që i akuzuari A..ishite duke ardhur, pasi që kishte biseduar në telefon. E kjo vërtetohet edhe nga veprimet e tij, pasi që nga dëshmitë e dëshmitareve, është vërtetuar se ai kishte qëndruar tek dera e automjetit të tij me telefon në dorë duke biseduar, po ashtu nga listingu i thirrjeve është vërtetuar se kishte komunikuar me të akuzuarin A... Prandaj duke marr për bazë faktin se nga dëshmitë e dëshmitareve është vërtetuar se dëshmitari Z.K., ishte larguar nga vendi i ngjarjes, i ndjeri T.B., ishte brenda në veturën e tij, prandaj qëndrimi i akuzuarit P.Gj., para dera e

veturës se tij dhe duke mos e lëvizur veturën e tij e tregon faktin se ai e priste djalin e tij, këtu të akuzuarin A... për të ardhur në vendin e ngjarjes dhe po ashtu pas kryerjes të vrasjes me automjetin e tij i akuzuari P. së bashku me të akuzuarin A.. largohen nga vendi i ngjarjes.

Gjykata nga deklarimi i vet të akuzuarit ka vërtetuar se ka pasur problem pronësor me këtu të ndjerin pasi që vëllai i tij M.. i ia kishte shitur te ndjerit një pjesë të tokës që ishte e përbashkët me të akuzuarin gjë për të cilën nuk ishte pajtuar, po ashtu Gjykata ka vërtetuar faktin se një ditë me parë i akuzuari nuk e kishte lejuar të ndjerin së bashku me punëtorët për ta rregulluar tokën gjë që ishte detyruar i ndjeri që ti largoj punëtorët vetëm për të mos ardhur tek ndonjë konflikt edhe pse e kishte lajmëruar se unë e kam blerë nga vëllai yt M.. dhe jam kam dhënë të hollat. Po ashtu Gjykata ka konstatuar se nga vet deklarimi i të akuzuarit në mbrojtën e tij është kontradiktor pasi që fillimisht është cekur se biseda e zhvilluar ka qenë e qetë ndërsa në shqyrtimin paraprak gjyqësor kishte deklaruar se kur kam shkuar në odën e A. ka fol daja dhe iu kam drejtuar dajës “dajë për çka me ke ftuar, çka kemi me bisedu” e ai më tha “ski çka me bisedua”, dhe iu drejtova “atëherë pse më keni thirr”. Daja më është drejtuar me fjalët se “ty tokën ta kanë marr edhe kojshia” pra e ka pasur fjalën për një komshi tjetër aty afër dhe është ngritur në këmbë dhe ma ka ngjitur për fyti dhe më ka thanë “të kam rreh edhe të rrehi” dhe kur është ngritur ai jam ngritur edhe unë edhe ai mu drejtua me fjalët “a don me e vra dajën” dhe i thashë se “nuk kam pushkë për dajën dhe as për askënd”. Ndërsa në rigjykim ka mohuar këto rrethana se ka ndodhur kjo, këtë e ka vërtetuar edhe dëshmitarja SH.N., e cila ka deklarua se kam dëgjuar bërtima në mes tyre dhe se i akuzuari ka qenë më e zëshmi. Po ashtu deklarimi tij është në kundërshtim me faktet pasi që i njëjti kishte deklaruar se pasi kemi dalë në rrugë kam komunikuar me A.. me telefon, i kam thënë “Bonu gati se kemi me shkua tek motra”. Ndërsa A... vjen me armë dhe pa biseduar me askënd e privon nga jeta të ndjerin, pra deklarimi i tij se bonu gati se kemi për të shkuar tek motra është kontradiktor sepse ky kishte veturën dhe kishte për të marr anëtarët, e jo të vie A.. i me armë, i cili kryen veprën penale, po ashtu ka deklarime kundërtëse lidhur me atë që janë konstatuar nga listingu i thirrjeve pasi që ka deklaruar se mua nuk po më kujtohet vetëm nëse e ka thirr bashkëshortja, ndërsa është vërtetuar se ka biseduar me A. para ngjarjes kritike jo vetëm një herë siç pretendon i akuzuari por tri herë sipas listisngurt të thirrjeve, andaj Gjykata nuk ia ka falur besimin mbrojtjes së të akuzuarit pasi që e njëjta është në kundërshtim me provat materiale dhe më dëshmitë e dëshmitarëve. Andaj, mbi këto baza dhe konstatime gjykata ka vërtetuar faktin se në veprimet e të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimit ekzistojnë dhe formohen të gjitha elementet e veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes nga neni 178 lidhur me nenin 33 të KPRK-së (Kodi penal nr.06/L-74).

4.Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, trupit gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i akuzuari P.GJ., me dashje eventuale ka kryer veprën penale të ndihmë në vrasje nga neni 178 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, në kohën, vendim dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

5. Elementet e veprave penale

Në nenin 178 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale të vrasjes e kryen: “Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta, dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim. Ndërsa në nenin 33 të KPRK, është parashikuar ndihma si formë e bashkëpunimit ashtu që paragrafi 1 ka parashikuar që: “Kushdo që me dashje ndihmon personin tjetër për kryerjen e veprës penale dënohet më dënim më të butë sesa kryesi i veprës”.

6. Vendimet e trupit gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, trupi gjykues të akuzuarin P.Gj., e ka shpallur fajtor ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes nga neni 178 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, dhe për këtë kanë vendosur që të akuzuarit ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

7. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit me rastin e matjes së dënimit, trupi gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana rënduese dhe lehtësuese. Si rrethana rënduese për të akuzuarin P.GJ., i ka marrë për bazë këto rrethana: dashjen eventuale të akuzuarit që të shkaktohet pasoja për shkak të problemit pronësor. Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata i ka marrë për bazë këto rrethana: moshën e tij i cili është i moshës 62 vjeçare, sjella e tij gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësore ka qenë e mirë ka pasur qëndrim tejet korrekt, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Prandaj duke marrë për bazë të gjitha këto gjykata ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimin e shqiptuar do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojnë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehin gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 lidhur me par.1 të KPP-së.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.198/21, me datë 22.03.2024

Zyrtarja Ligjore,
Arbënore Basha

Kryetari i Trupit Gjykues- Gjykatësi,
Drilon Haraçia

Numri i lëndës: 2019:079482
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05493982

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.